

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5462
E premte, 27 prill 2018
çmimi 0.40 €

**BPSK-ja
bën
thirrje
për
protestë
më 1
maj**



FAQE 4-5

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



PRESIDENTI I KËSHILLIT EVROPIAN, DONALD TUSK, KA VIZITUAR KOSOVËN DHE ËSHTË PRITUR NË TAKIM NGA PRESIDENTI I VENDIT, HASHIM THAÇI

Porosia e Tuskut: Luftojini krimin dhe korrupsionin



- Pa normalizim të marrëdhënieve Kosova dhe Serbia nuk afrohen me BE-në

Presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk, ka thënë se Kosova duhet t'i luftojë krimin e organizuar dhe korrupsionin, duhet ta vazhdojë procesin e reformave si dhe procesin e dialogut me Serbinë. Këto porosi Tusku i ka dhënë të enjten në Prishtinë, pas takimit që ka pasur me presidentin Hashim Thaçi. Presidenti i Këshillit Evropian e ka përgëzuar Kosovën për miratimin e demarkacionit me Malin e Zi, duke potencuar se ky veprim i ka mundësuar Kosovës t'i ofrohet më shumë regjimit pa viza në vendet e BE-së. Tusku ka deklaruar se në Bruksel dhe në kryeqytetet evropiane i vlerësojnë arritjet e shtetit të Kosovës

Kosova kërkon përkrahjen e faktorit ndërkombëtar për transformimin e FSK-së

Kryeministri Ramush Haradinaj dhe ministri i FSK-së, Rustem Berisha, kanë kërkuar të enjten ndihmën e partnerëve ndërkombëtarë për transformimin e Forcës

së Sigurisë së Kosovës, që pjesë e këtij procesi të jetë edhe Lista Serbe. "Përkushtimi ynë është që edhe në të ardhmen ta vazhdojmë përgatitjen e FSK-së për tranzi-

cion. Kërkojmë mbështetjen dhe ndihmën e juaj, që edhe Lista Serbe të jetë pjesë e këtij procesi", është shprehur ministri i FSK-së, Rustem Berisha ■ FAQE 7



AKTUALE

ËSHTË KOHA PËR MËSIM DHE MËSUES BASHKËKOHORË F. 6

PROF. ASS. DR. RAGIP GJOSHI

SHQIPTARËT E HUMBIN ULQININ F. 2

HARADINAJ E KURTI POLEMIZOJNË PËR ENERGJINË F. 5

EKONOMI

NËNSHKRUHET MARRËVESHJA PËR FUNKSIONALIZIMIN E PARKUT TË BIZNESIT NË THERANDË F. 8

TELEKOMI FITON KONTESTIN GJYQËSOR ME AXOS-in NË GJYKATËN E ARBITRAZHIT F. 8

KULTURË

MINISTRI GASHI: KOSOVA KA BËRË HAPA TË MËDHENJ PËR TË DREJTAT E AUTORIT F. 13

SPORT

JASHARI: E MPOSHTIM PRISHTINËN DHE E NDJEKIM TITULLIN F. 15

NORA, E ARTË NË IZRAEL; DISTRIA, E ARGJENDTË F. 14

Partitë të arrijnë konsensus për reformën zgjedhore

Njohësit e proceseve zgjedhore në vend kanë ftuar subjektet politike të arrijnë një konsensus për vazhdimin e reformës zgjedhore. Sipas tyre, partitë duhet ta tregojnë vullnetin politik që këtë proces ta përfundojnë para zgjedhjeve të reja nacionale. Ata kanë vlerësuar se çfarëdo zgjedhesh të shpejta, pa një reformë të tillë, nuk garantojnë stabilitet për qeverinë e ardhshme ■ FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sut.styro@yubion.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Shqiptarët e humbin Ulqinin

ULQIN, 26 PRILL - Të enjten në Ulqin është konstituuar Kuvendi i ri i Komunës së Ulqinit, me ç'rast kryetar i ri Kuvendit u zgjodh Ilir Çapuni nga radhët e Forcës. Zgjedhjen e tij e përkrahën publikisht 30 anëtarët e koalicionit qeverisës në parlamentin lokal (DPS, Forca, Koalicioni "Zgjohu Ulqin", UDSH, SD dhe Partia Boshnjake), kurse abstenuan tre këshilltarë të opozitës, dy

nga URA dhe një nga Partia Social Demokratike, ka njoftuar Malësia.

Kryetari i komunës, siç janë dakorduar nga koalicioni qeverisës, do të jetë nga radhët e DPS-së. Kjo është hera e parë që kryetari i Komunës së Ulqinit nuk do të jetë nga partitë shqiptare.

Një nga tre këshilltarët e vetëm opozitarë, Ilir Harasani nga Lëvizja URA, ka thënë se ka

ardhur sot në këtë institucion i veshur me të zeza. "Intervistë për TV Vijesti, RTK dhe TVT. Sot jam veshur me të zeza sepse është ditë zie për parlamentarizëm. Kanë vdekur vlerat demokratike nga 33 këshilltarë 30 në pozitë. Për herë të parë kryetari do t'i takojë DPS-së. Sot jemi kthyer në komunizëm", ka shkruar Harasani në një postim në "Facebook".



Rama: Vizita në Gjermani ishte e suksesshme, na pyetën për Tahirin

Kryeministri Edi Rama tha se vizita në Gjermani i përmbushi pritshmëritë që kishte qeveria e tij dhe se në Komisionin e Çështjeve Evropiane është pyetur në lidhje me çështjen "Tahiri"

TIRANË, 26 PRILL - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, e ka vlerësuar vizitën në Gjermani si të suksesshme. Në konferencën e dhënë për mediet në Aeroportin e Rinasit, pas kthimit nga Berlina, Rama tha se vizita në Gjermani i përmbushi pritshmëritë që kishte qeveria e tij. I pyetur nga gazetarët nëse në Gjermani, kancelarja Merkel i ka kërkuar arrestimin e ish-ministrit Saimir Tahiri, kryeministri Edi Rama tha se me kancelaren ka folur për integrimin dhe reformat. "Me kancelaren kemi folur në detaje për të gjitha aspektet e Raportit të Progresit, për ecurinë e reformës në drejtësi dhe patjetër për progresin e bërë me vettingun që, sikur e dini edhe ju, përbën një moment me rëndësi dhe ka një vëmendje të veçantë nga Gjermania", tha kryeministri Edi Rama.

Kryeministri Rama u pyet disa herë nga gazetarët lidhur me çështjen "Tahiri" dhe u sollën në vëmendje deklaratat e ministrit gjerman, Michael Roth, i cili tha

për "Deutsche Welle"-n se Ramës i ka thënë se drejtësia duhet të veprojë edhe për Saimir Tahirin.

Lidhur me këtë deklaratë të ministrit gjerman, Rama tha: "Është bërë një pyetje në Komisionin e Çështjeve Evropiane lidhur me këtë çështje, pyetje që ka pasur të bëjë edhe me baltën e eksportuar atje dhe me tregimin e deformuar këtu. Ne ishim në Gjermani, jo në Venezuelë, që të na kërkonin arrestimin, pasi në Gjermani e dinë që kur marrin qumështin e nënës se nuk jemi ne që arresojmë, por është drejtësia", tha Rama.

I pyetur për kritikën e deputetit gjerman Gunther Krichbaum, Rama tha se Krichbaum përfaqëson një nga qindra deputetët e Bundestagut dhe mendimi i tij nuk ndryshon raportin e Komisionit Evropian. Kreu i Qeverisë ka thënë se çdo koment që është bërë në Gjermani për çështje jashtë raportit të KE-së ishte i njëjtë me ato që janë thënë nga opozita në Tiranë, duke nënkuptuar për



lobim të PD-së kundër integritetit të vendit në BE.

Mediet kanë njoftuar të enjten se në kuadër të Internacionales

Socialiste, Rama ishte ftuar aty të diskutonte me ministrin gjerman për Evropën, Michael Roth, për Shqipërinë dhe mundësinë e

çeljes së negociatave. Roth vuri në dukje se çelja e negociatave nuk pritet me eufori nga vendet anëtare të BE-së. "BE-ja po kalon kohë të vështira, sepse ka një sërë problemesh të brendshme dhe nuk është e gatshme për anëtarë të rinj", tha ai.

Veç lëvdatave për arritjet në procesin e vettingut, Roth nuk harroi t'i kujtonte mikut të tij socialist, se reforma gjyqësore pa një proces kundër ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri, nuk mund të bëhet. Ndaj duhet filluar procesi gjyqësor kundër ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahirit, për të dëshmuar kështu se pavarësia e gjyqësorit me të vërtetë funksionon", tha Roth.

Vuçiq: Marrëveshja me Kosovën, për gjashtë muaj ose një vit

LONDËR, 26 PRILL - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka deklaruar se beson se brenda "gjashtë muajsh apo një viti", mund të arrihet një marrëveshje përfundimtare me Kosovën. "Jemi të gatshëm të bisedojmë për çdo çështje. Ne jemi të gatshëm të marrim në konsideratë çdo propozim i cili do të nënkuptonte një zgjidhje



arrijnë marrëveshje ligjërish të obligueshme për këtë qëllim.

kompromisi", ka thënë Vuçiqi në një intervistë për gazetën britanike "The Guardian".

Kosova dhe Serbia që prej vitit 2011 janë duke mbajtur në Bruksel bisedime të nivelit të lartë për normalizimin e marrëdhënieve. Është thënë se të dyja shtetet duhet të

Xhaferi: Ivanovi po kryen vepër penale që nuk vjetrohet

SHKUP, 26 PRILL - Me mbarimin e mandatit të presidentit, Gjorgje Ivanov mund të përballet me Ligjin për keqpërdorim të detyrës zyrtare që po e bën me mosdekretimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve. Kështu vlerëson kryeparlamentari Talat Xhaferi, i cili i bën thirrje presidentit të reflektojë për këtë çështje. "Mendoj se duhet të reflektojë. Ai mund të fshihet pas pushtetit

që ka sot për përgjegjësinë, pas imunitetit, por në momentin e skadimit të mandatit, atij mund t'i aktivizohet përgjegjësia penale për shkelje të Kushtetutës, për të cilën s'ka kush e shpëton nga ajo përgjegjësi. Janë çështje për të cilat mendoj se duhet të reflektojë", tha Xhaferi, transmeton TV21.

Sipas nenit 75 të Kushtetutës, ndër të tjera thuhet se presidenti

ka për detyrë ta nënshkruajë ligjin i cili është votuar me shumicë parlamentare. "Presidenti e ka për detyrë ta nënshkruajë dekretin në qoftë se, sipas Kushtetutës, ligji nxirret me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve", neni 75 i Kushtetutës së RM-së.

Ndonëse Ligji për përdorimin e gjuhëve është rishqyrtuar në

Kuvend dhe është miratuar me shumicën votash, me mosnënshkrimin, sipas Xhaferit, presidenti është bërë pengesë e institucionit më të lartë ligjvënës. Xhaferi gjithashtu tha se Ivanovi një ditë mund të përgjigjet për keqpërdorim të detyrës zyrtare, të parashikuar në nenin 353 të Kodit Penal, e cila, sipas tij, është vepër penale që nuk vjetrohet asnjëherë. Kryeparlamentari shtoi se



Kushtetuta i jep atij mundësinë ta nënshkruajë ligjin dhe ta arsyetojë shpalljen pa firmën e presidentit, andaj shumë shpejt ligji të publikohet në "Gazetën Zyrtare".

Partitë të arrijnë konsensus për reformën zgjedhore

Njohësit e proceseve zgjedhore në vend kanë ftuar subjektet politike të arrijnë një konsensus për vazhdimin e reformës zgjedhore. Sipas tyre, partitë duhet ta tregojnë vullnetin politik që këtë proces ta përfundojnë para zgjedhjeve të reja nacionale. Ata kanë vlerësuar se çfarëdo zgjedhjesh të shpejta, pa një reformë të tillë, nuk garantojnë stabilitet për qeverinë e ardhshme

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 26 MARS - Njohësit e proceseve zgjedhore dhe përfaqësuesit e subjekteve politike kanë bërë me dije se partitë politike së shpejti duhet të arrijnë një konsensus për ta filluar reformën zgjedhore, e cila është edhe kërkesë e Bashkimit Evropian (BE). Ata kanë deklaruar se Kosova nuk duhet të rrezikojë që të shkojë në zgjedhje të reja pa e përfun-

duar reformën zgjedhore.

Koordinatori Nacional për Reforma Shtetërore, Besnik Tahiri, ka deklaruar për gazetën "Epoka e re" se ky proces kërkon vullnet politik të partive politike. Sipas tij, ky proces kërkon një analizë të thellë profesionale. "Ndërkaq sa i përket reformës zgjedhore, ky proces është iniciuar nga presidenti i Republikës së Kosovës por kjo, para së gjithash, kërkon konsensus dhe vullnet politik nga subjektet politike. Në këtë

proces është e domosdoshme një analizë e thellë profesionale duke nxjerrë në pah përparësitë dhe mangësitë e sistemit aktual në mënyrë që në procesin e reformës zgjedhore të kemi qartësi të plotë. Njëkohësisht është tejet e rëndësishme të kemi gjithëpërfshirje dhe analizë të modeleve të sprovuara, gjithnjë duke u përshtatur me kontekstin", ka thënë Tahiri. Edhe kryetari i Lëvizjes për Bashkim, Valon Murati, ka vlerësuar se para çfarëdo vendimi për zgjedhje të ardhshme, partitë politike duhet të arrijnë një konsensus për reformën zgjedhore. "Çfarëdo zgjedhjesh të shpejta nuk garantojnë stabilitet për Qeverinë e ardhshme. Para çfarëdo vendimi për zgjedhje të ardhshme, partitë politike duhet të arrijnë një konsensus për reformën zgjedhore. Çfarëdo zgjedhjesh në nguti, e pa reformë zgjedhore, do të vazhdojnë të deformatojnë jo vetëm vullnetin e votuesve, por edhe sistemin e

vlerave brenda subjekteve politike. Rrjedhimisht, do të kemi çdoherë e më pak institucione legjitime, sepse sistemi aktual krijon hapësirë të madhe për manipulime brenda listave të partive politike", ka deklaruar për gazetën Murati. Të nevojshme këtë reformë e shohin edhe zyrtarët e PDK-së dhe të LDK-së. Anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nga radhët e PDK-së, Betim Gjoshi, ka thënë se nuk duhet të shkohet në zgjedhje të parakohshme parlamentare pa u përfunduar reforma zgjedhore. "Kjo çështje është në vullnetin e partive politike por, sipas mendimit tim, nuk do të shkonim në zgjedhje pa një reformë zgjedhore. Reforma do t'i eliminonte problemet të cilat po i përcjellin proceset zgjedhore. Pa marrë parasysh se këto katër-pesë palë zgjedhjet e fundit ishin sipas standardeve ndërkom-bëtare, ka disa nevoja të domosdoshme që i kemi

adresuar si KQZ të Kuvendi, të cilat duhet të marrin përgjigje", është shprehur Gjoshi. Sipas tij, kjo është edhe kërkesë e BE-së. "Muajin e kaluar shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian, Natalya Apostolova, ka filluar një iniciativë për adresim të rekomandimeve të vëzhguesve të BE-së dhe në mesin e tyre janë edhe disa adresime për reformë zgjedhore. Pjesë e këtij takimi kanë qenë edhe përfaqësuesit e partive politike si dhe kanë dhënë zotime se secili nga përgjegjësit e vet do të marrë edhe hapa konkretë për të mbështetur një reformë të përgjithshme, e cila do ta përfshijë kodin zgjedhor, ligjin për partitë, pra do ta përfshinte komplet kuadrin ligjor sa iu përket zgjedhjeve", ka thënë ai. Kurse ish-anëtar i KQZ-së nga LDK-ja, Florian Dushi, ka thënë se, ndonëse një reformë e tillë është e nevojshme, tani për tani nuk ka ndonjë iniciativë në këtë drejtim. "Nëse e kemi parasysh faktin se Kosova tashmë ka humbur ritmin e ciklit të paraparë kushtetues të mbajtjes së zgjedhjeve të rregullta (sepse tri palë zgjedhje pas shpalljes së pavarësisë ishin zgjedhje të jashtëzakonshme), problemet me të cilat ballafaqohet qeveria aktuale, e cila me shumë vështirësi edhe ka siguruar mbështetje në Kuvendin e Kosovës që në momentin e formimit të saj, atëherë me lehtësi mund të konkludojmë se, nëse së shpejti nuk do të kemi një iniciativë serioze rreth reformës zgjedhore, vendi ynë sërish mund të 'zihet' në befasia nga zgjedhje të reja e të jashtëzakonshme, por me sistem të vjetër zgjedhor", ka thënë Dushi.

Procesi i reformës zgjedhore ka filluar pas zgjedhjeve nacionale të vitit 2010 dhe ende nuk ka përfunduar. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në vitin 2016 kishte nisur takimet me partitë politike dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile për reformën zgjedhore, por edhe kjo nisje ka mbetur pezull.



BE-ja i kërkon Prishtinës ta themelojë urgjentisht asociacionin

PRISHTINË, 26 PRILL - Bashkimi Evropian (BE) i ka kërkuar Prishtinës që urgjentisht dhe pa vonesë ta zbatojë marrëveshjen për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Zëdhënësja e BE-së, Maja Kocijançiq, e ka cilësuar pozitiv faktin që ka nisur puna për hartimin e statutit të këtij asociacioni, duke thënë se

autoritetet e Kosovës kanë afat katër muaj që të zbatojnë plotësisht këtë marrëveshje. "Presim rezultate. Është e nevojshme të zbatohet kjo marrëveshje, ashtu si edhe të gjitha të tjerat", është shprehur Kocijançiq, raporton "REL". Marrëveshja për Asociacionin është arritur në gusht të vitit 2015 dhe

Prishtina ka nisur hartimin e statutit vetëm pak kohë më parë. Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka thënë se themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe duhet të ndodhë paralelisht me anëtarësimin e Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB).



Presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk, ka vizituar Kosovën dhe është pritur në takim nga presidenti i vendit, Hashim Thaçi.

Porosia e Tuskut: Luftojini krimin dhe

- Pa normalizim të marrëdhënieve Kosova dhe Serbia nuk afrohen me BE-në

Presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk, ka thënë se Kosova duhet t'i luftojë krimin e organizuar dhe korrupsionin, duhet ta vazhdojë procesin e reformave si dhe procesin e dialogut me Serbinë. Këto porosi Tusk i ka dhënë të enjten në Prishtinë, pas takimit që ka pasur me presidentin Hashim Thaçi. Presidenti i Këshillit Evropian e ka përgëzuar Kosovën për miratimin e demarkacionit me Malin e Zi, duke potencuar se ky veprim i ka mundësuar Kosovës t'i ofrohet më shumë regjimit pa viza në vendet e BE-së. Tusk ka deklaruar se në Bruksel dhe në kryeqytetet evropiane i vlerësojnë arritjet e shtetit të Kosovës

**EPOKA
ERE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 26 PRILL - Presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk, ka thënë të enjten në Prishtinë se pa një normalizim gjithëpërfshirës të marrëdhënieve, Kosova dhe Serbia nuk mund të ofrohen me Bashkimin Evropian. Ai ka theksuar se kjo është një çështje shumë e vështirë për të dyja palët por, sipas presidentit Tusk, nuk ka alternativë tjetër të qëndrueshme për normalizim. "Diskutuar edhe për gjendjen e dialogut në mes të Prishtinës dhe Beogradit. Pa një normalizim gjithëpërfshirës të marrëdhënieve me Serbinë dhe implementim të plotë të marrëveshjeve, unë nuk di se si mund të arrihet përparim në raportet me Bashkimin Evropian. E di se do të jetë e vështirë, por unë ende

jam optimist. E falënderoj presidentin Thaçi njësoj siç e falënderova presidentin Vuçiq për kapitalin personal që kanë investuar në dialog. Unë e di se kjo është një çështje e ngarkuar emocionalisht dhe shumë e vështirë për të dyja palët, por nuk ka alternativë tjetër të qëndrueshme për normalizimin. Në fakt, bëhet fjalë për një vendim strategjik për të cilin jam i bindur se do të shpaguehet në afat të gjatë", ka deklaruar presidenti Tusk në një konferencë të përbashkët për medie me presidentin Hashim Thaçi.

Përveç vazhdimit të dialogut, presidenti Tusk ka porositur institucionet e Kosovës që të vazhdojnë luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Megjithatë, ai ka thënë se për të pasur rezultate në këtë drejtim duhet konsensus politik në Kosovë. "Luftimi i krimit të



organizuar dhe korrupsionit kërkon konsensus politik në Kosovë dhe me konsensusin tuaj besoj se kemi mundësinë të vazhdojmë me këtë politikë spektakulare dhe shumë pozitive. Angazhime të përhershme për ta ndërtuar konsensusin në Kosovë, po ashtu edhe në rajon", është shprehur Tusk, duke shtuar se Kosova duhet ta vazhdojë procesin e reformave, duke respektuar zotimet ndërkombëtare.

Presidenti i Komisionit Evropian, Donald Tusk, ka përgëzuar Kosovën për ratifikimin e demarkacionit me Malin e Zi, duke thënë se ky veprim i ka mundësuar

Kosovës t'i ofrohet më shumë regjimit pa viza në vendet e BE-së. "Unë dua t'ju përgëzoj për ratifikimin e marrëveshjes për shënimin e kufirit me Malin e Zi. Kjo i ka mundësuar Kosovës të bëjë një hap tjetër për t'iu ofruar më shumë regjimit pa viza të udhëtimit në Bashkimin Evropian. Kjo është një dëshmi e bashkëpunimit ndërpartiak për çështjet e interesit të përgjithshëm të Kosovës. Tani e di se ju nuk do të ndaleni dhe të hiqni dorë, por do t'i vazhdoni proceset e reformave, duke i respektuar zotimet dhe përkushtimet ndërkombëtare. Jam i sigurt se nuk do të hiqni dorë nga kjo", ka deklaruar

Tusk. Ai ka thënë se Bashkimi Evropian (BE) është dhe do të vazhdojë të jetë partneri më i besueshëm i mbarë rajonit. Tusk ka bërë me dije se BE-ja në Samitin e Sofjes duhet ta riafirmojë mbështetjen e saj të qartë për perspektivën evropiane të rajonit dhe ta mirëpresë përcaktimin strategjik dhe angazhimin e përbashkët të partnerëve të saj në Ballkanin Perëndimor ndaj parimeve, vlerave dhe unitetit evropian. Ndërsa presidenti Hashim Thaçi ka thënë se është e qartë që Kosova ka një nevojë urgjente për t'i përshpejtuar hapat drejt anëtarësimit në BE. "Kosova është e bekuar, sepse reflekton një mbështetje qytetare absolute ndaj BE-së dhe vlerave të saj. Mirëpo, Kosova ka nevojë për konkretizim të perspektivës së vet evropiane dhe ambicia jonë minimale është që në një periudhë sa më të shkurtër ta marrim statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE", ka thënë Thaçi, duke shtuar se me presidentin Tusk kanë diskutuar edhe për liberalizimin e vizave që, sipas tij, është çështja më urgjente në rrugën e Kosovës evropiane. Ai ka theksuar se Kosova mbetet e interesuar jo vetëm ta vazhdo-



Thaçi korrupsionin



Thaçi më 9 maj takohet me Merkelin në Berlin

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë me dije se më 9 maj do të takohet me kancelaren e Gjermanisë, Angela Merkel. Thaçi në konferencën e përbashkët për medie me presidentin e Këshillit Evropian, Donald Tusk, ka thënë se kjo vizitë në Gjermani do të bëhet me ftesë të kancelares gjermane Angela Merkel.

jë dialogun me Serbinë, por edhe ta kthejë në një proces të mirëfilltë të pajtimit dhe të ndërtimit të paqes së qëndrueshme në rajon. "Ne folëm edhe për përkushtimin tonë për procesin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të lehtësuar nga Bashkimi Evropian. Ky përkushtim nënkupton zbatimin e marrëveshjeve të arritura deri më tani, por edhe lëvizjen drejt një marrëveshjeje përfundimtare të obligueshme ligjrisht, që do të mundësojë njohje reciproke dhe integrimin në BE", ka deklaruar Thaçi. Sipas Thaçit, Bashkimi Evropian dhe rajoni i Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë këtu edhe Kosovën, nuk kanë qenë kurrë më afër njëri-tjetrit se sot. "Mirëpo, mendoj se të

dyja palët, pra BE-ja dhe shtetet e Ballkanit Perëndimor, e kanë kuptuar se bashkërisht mund të bëjmë shumë më shumë, që sa më shpejt të realizojmë në praktikë atë që BE-ja e ka riaktualizuar në mënyrë të qartë përsëri, 15 vjet nga Samiti i Selanikut, pra anëtarësimin e të gjitha shteteve të Ballkanit Perëndimor në BE. Prandaj, unë në çdo rrethanë e konsideroj si të arritur që 15 vjet më vonë, tani në Samitin e Sofjes, të gjitha shtetet anëtare të BE-së dhe të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor, do ta kenë mundësinë që përballë njëri-tjetrit të reflektojmë për arritjet e shumta që janë bërë në rrugëtimin tonë të përbashkët, padyshim edhe për sfidat e procesit", është shprehur Thaçi.

Haradinaj e Kurti polemizojnë për energjinë

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 26 PRILL - Diskutimi për sistemin e energjisë në vend, në seancën e Kuvendit të Kosovës ka nxitur të enjten një debat në mes të kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurtit dhe kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj.

Në fjalën e tij Albin Kurti ka thënë se Kosova aktualisht nuk ka një strategji zhvillimore për energjinë. "Mospasja e saj na ka sjellë në pikën që në dhjetë vjetët e fundit na kanë sjellë nga 300 megavatë në kontratën e fundit në 500 megavatë. Në vend se të ketë strategji të planifikimit, po planifikohet dekomisionimi i 'Kosovës A', ka thënë Kurti, i cili ka folur edhe për ndërtimin e TC "Kosova e Re", duke thënë se kontrata prej 1.3 miliard eurosh shkakton dëme të trefishta. "Rritja enorme e çmimit të energjisë elektrike, falja e tokës të një kompani private, shteti e merr përsipër tërësisht rrezikun dhe ia garanton shitjen e plotë dhe fitimin kompanisë private", ka shtuar ai.

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje ka thënë se Qeveria e Kosovës nuk ka kapacitete njerëzore e profesionale për sektorin e energjetikës. "Në Qeverinë e Kosovës nuk ka kapacitet njerë-

zor që e njej sektorin e energjetikës. Ata më të zotët janë jashtë sektorit publik. Avni Kurshumliu u nda nga kjo jetë duke trokitur në çdo derë se është në interes të Kosovës rindërtimi i 'Kosovës A', edhe profesionistët e tjerë, po mendimi i tyre nuk u mor parasysh", ka deklaruar Kurti në interpelancën e cila ishte thirrur për kryeministrin në lidhje me reduktimet e ashpra të furnizimit me energji elektrike dhe situatën në sektorin e energjisë.

Më tej, ai ka folur edhe për interkoneksionin me Shqipërinë, për të cilin tha se për shtatë vjet me radhë janë dëgjuar deklarime se në këtë muaj apo atë muaj do të fillojë operimi i interkoneksionit. Në këtë drejtim Kurti ka thënë se në vend të zgjidhjes, kjo ka shkuar në negociata në Bruksel. Sipas Kurtit, me ndërtimin e termocentralit "Kosova e Re" çmimi i energjisë do të rritet. Pas fjalës së Albin Kurtit në foltoren e Kuvendit doli kryeministri Ramush Haradinaj. "Ne kemi shkruar shumë strategji, por problemi ka qenë te zbatimi i tyre. Nëse nuk e kishim bërë edhe këtë kishim mbetur pa hijë. Të rrezikuar jemi edhe tash. Jemi duke luftuar që mos të rritet çmimi i energjisë. Gjatë këtij dimri kemi importuar energji me çmim më të lartë sesa që e prod-

hojmë", ka thënë Haradinaj.

Përsëri e mori fjalën Albin Kurti, i cili i tha kryeministrit se të dy kanë pikëpamje shumë të ndryshme. "Unë nuk besoj se kjo qeveri është e re. Mund të ketë fytyra të reja, por orientimi nuk ka ndryshuar. Minimumi që është dashur të bëni është ta denonconi krimin e organizuar. Është detyrë e juaj si kryeministër t'i hapni dosjet. Ju në një farë forme e keni marrë stafetën në të njëjtin rreth. Ju po dëshironi që ndryshimi që ju ka ndodhur juve ta bartni të gjithë ne, por nuk është ashtu", është përgjigjur Kurti. Lideri i LV-së ka thënë se strategjia ka ardhur në Kuvend pasi është nënshkruar kontrata me "Contour Global".

Fjalën për replikë e mori përsëri kryeministri Haradinaj, i cili tha se nëse trendi i qeverisjeve ka qenë për të mbetur pa qymyr, me ardhjen e tij në Qeveri kjo ka ndryshuar. Kurse Albin Kurti iu përgjigj se cili person të ishte në këtë mandat do ta kishte bërë këtë. "Ti ke qellu dhe e ke bo, ama është shumë vonë", është shprehur Kurti. Përsëri kryeministri e mori fjalën për t'iu përgjigjur Kurtit duke i thënë se nuk është ambicie e vogël për ta ndaluar bankrotimin. Haradinaj ka bërë me dije se ka shpenzuar orë të tëra duke biseduar me njerëzit për shpronësime.



Kuvendi miraton rekomandimet për skandalin e mishit

Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë miratuar të enjten rekomandimet e propozuara nga deputetja e PDK-së, Ganimete Musliu dhe deputetë të tjerë, rreth skandalit të mishit, pas debatit të mbajtur në seancën e kaluar. Sipas rekomandimeve të miratuara, kryeministri duhet të marrë

masa adekuate ndaj përgjegjësve të bordit dhe menaxhmentit të AUVK-së; organet e drejtësisë të fillojnë menjëherë hetime përgjegjëse publike dhe subjekteve private që sjellin në treg produkte të dyshimtë; në funksion të rritjes së transparencës AVUK t'i pasqyrojë të gjitha të dhënat e veprimtarisë së inspek-

torëve në baza ditore; të rishikohet legjislacioni përkatës që saktëson periudhat kohore minimale para skadimit të afatit të përdorimit të produkteve ushqimore që importohen në Kosovë; dhe të rritet mbështetja financiare për masat e mbështetjes së programit për zhvillim rural që rritë prodhimin vendor.

Në këtë epokë të dijeve dhe epokë digjitale, çfarë arsimit na duhet?

Është koha për mësim dhe mësuës bashkëkohorë



**Prof. ass. dr. Ragip
GJOSHI**

MASHT-i dhe universitetet tona është koha e fundit t'i ndalojnë trendet e deritashëm pengues. Nëse shteti ka rezervuar të drejtën e formimit intelektual e profesional të mësimdhënësve, do të duhej patjetër që këtë të drejtë ta ruajë deri në fund. Pra, shteti duhet ta rezervojë edhe të drejtën e zhvillimit profesional të mësuësve. Për përfshirjen institucionale dhe me përgjegjësi të universiteteve në skemën e zhvillimit profesional të mësuësve, kërkohet të ristrukturohet zhvillimi profesional i mësuësve. Në kuadër të reformimit të arsimit të lartë, në arsimin universitar mendoj se duhet përfshirë edhe kjo çështje. Nga universitetet duhet të kërkohet që mësuësit të ofrohen pranë universiteteve për t'i freskuar dhe shtuar dijet e tyre shkencore, herë-herë të

harruara, të vjetruara, apo të pamësuara mirë në kohën e jetës si studentë, pjesë të kurrikulave të reja të përfshira në përmbajtjen e kurrikulës universitare dhe të munguara në formimin e mësuësve. Një projekt i përmasave kombëtare (që do të duhej t'u besohet Fakulteteve të Edukimit që janë ndër më të përgatiturat), për këtë qëllim, do të dimensionohet në disa nivele: 1. Projekte dhe module të detyrueshme ku të përfshihen çështje që lidhen me formimin e përgjithshëm shkencor dhe kurrikular të mësuësve për shtim dhe freskim dijesh dhe praktikash bashkëkohore. Përgjegjës për këtë nivel duhet të jenë këto universitete që paraprakisht për këtë destinim do të duhej të akreditoreshin; 2. Projekte dhe module të rëndësishme të cilat përfshijnë çështje që lidhen me tema të rëndësishme të organizimit të mësimdhënies, me risi didaktike që qarkullojnë në vazhdimësi. Ky nivel mund të kryhet nga universitetet, kryesisht programet e të cilave kanë kaluar në një vlerësim të fortë nga institucione të certifikuara; 3. Projekte dhe module specifike, të cilat mund t'i zgjedhin mësuësit, sipas nevojave dhe interesave profesionale të tilla

si: edukimi i fëmijëve me nevojat të veçanta, autikë etj. Skemat e trajnimit të mbështetura në modele të tilla si kllaster, kaskadë, apo mbi bazë shkollë, nevojiten dhe mund të përdoren kur kemi çështje të përbashkëta për të cilat duhet të marrin dijeni të gjithë mësuësit, përfshirë edhe mësimdhënësit në arsimin profesional. Përkufizimi ligjor dhe përfshirja e mësuësve në skema të tilla me një projekt sistematik pa dyshim se reflekton edhe rezultatin. Përfshirja e universiteteve në fushën e formimit të vazhdueshëm të mësuësve duhet të kuptohet dhe zbatohet edhe për shumë arsye të tjera, si: Formimi i mësuësve sipas kërkesave bashkëkohore evropiane. Futja e qëndrueshme e universiteteve në sistemin e ofruesve të shërbimeve për mësuësit në detyrë, e kjo shumëfishon vlerat e profesionit të mësuësit. Universiteti ka fuqinë ta sjellë profesionalizimin për të kuptuar dhe për t'i trajtuar problemet e shkollës. Vlera e shtuar pritet në rritjen e cilësisë së punës së mësuësit. Futja e universiteteve në sistemin e përgatitjes së mësuësve diktohet nga domosdoshmëria e modernizimit të profesionit të

mësuësisë. Përfshirja e universiteteve për më shumë kontribut lidhur me aftësimin e mësuësve, me detyrat e tyre dhe me detyrimet e shkollës, është domosdoshmëri edhe për faktin se vetë universitetet kanë nevojë të mësojnë dhe të freskohen dhe të mësojnë çfarë ndodh në shkollë. Është shans i ri dhe kontribut për marrjen e rezultateve dhe cilësisë së dëshiruar sistemi arsimor (parauniversitar dhe universitar). Këto programe do të definonin se ç'duhet të bëjnë shkollat? Ky program do t'i definonte edhe nevojat e nxënësit apo kushtet e sistemit. Këto do të ishin prurjet parauniversitare. Por, kjo është një sfidë e madhe për mësuësit dhe nuk mund ta kapërcejnë lehtë. Shkollat dhe mësuësit kanë nevojë për universitetet dhe përfaqësuesit e ekonomisë të përpunojnë me individë të suksesshëm. Futja e universiteteve në përgatitjen dhe trajnimin e mësuësve do ta lehtësonte çështjen e balancës kurrikulare dhe do t'i bënte më të frytshme prurjet parauniversitare në botën e arsimit universitar ose të prodhimit. Formimi i vazhdueshëm i mësuësve nuk është investim për të ardhmen. Universitetet duhet ta marrin rolin e liderit, edhe pse dinami-

ka e jetës është imponuese, që shkolla do të vijojë të tregojë ndjeshmëri. Universitetet duhen të jenë ndihmësit më të afërt të mësuësve, pasi kanë detyrë t'i njohin si strategjitë bashkëkohore të mësimdhënies, ashtu edhe informacionin më të fundit se si nxënë fëmijët. Ata mund të ndihmojnë shumë më shumë se të gjithë aktorët e tjerë në identifikimin e strategjive dhe të rrugëve të kryerjes së përgjegjësisve profesionale në shkolla. Universiteti ofron zhvillim profesional në specializuar në bazë shkollë. Nevojat e mësuësve janë të ndryshme. Edhe pse mund të punojnë në të njëjtin vend, ato nuk ngjajnë me nevojat e kolegëve të së njëjtës shkollë. Përmes kësaj strukture ai është një ushqyes i natyreshëm për formimin e mësuësve sipas nevojave personale. Programet për zhvillim profesional të këtyre njësive shkencore mbi bazë shkollë mund të orientohen nga departamentet universitare. Fare në fund, kam bindjen se roli i universiteteve duhet të jetë shumë i fortë në fushën e zhvillimit profesional të mësuësve, me synim rritjen e cilësisë së arsimit në tërësi.

(Vijon nga numri i kaluar.
Fund)



Nënshkruhet marrëveshja për funksionalizimin e Parkut të Biznesit në Therandë

THERANDË, 26 PRILL (ER) - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) dhe Komuna e Therandës kanë nënshkruar të enjten një memorandum bashkëpunimi për funksionalizimin e parkut të biznesit në vlerë 2-3 milionë euro, me qëllim që bizneset të ushtrojnë veprimtarinë e tyre dhe të punësojnë njerëz në këtë komunë. Memorandumi është nënshkruar ndërmjet ministrit të MTI-së, Bajram Hasani dhe kryetarit të Therandës, Bali Muharremaj. Ministri Hasani ka vlerësuar se memorandum i nënshkruar ka një rëndësi të madhe për zhvil-

limin ekonomik të Komunës së Therandës, përfshirë edhe rritjen e vendeve të punës. Edhe kryetari i Therandës, Bali Muharremaj, ka thënë se ky memorandum ka një rëndësi të madhe për zhvillimin e bizneseve në këtë komunë. Ndërsa zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, i cili ka qenë i pranishëm gjatë nënshkrimit të këtij memorandum, ka thënë se Kosovës i duhen njerëz energjikë. "Ne me kënaqësi në emër të Qeverisë kemi ardhur ta nënshkruajmë këtë projekt për parkun që është në kuadër të projektit dhe që hap mundësi për punësim për 600 vende të punës", ka thënë Limaj.

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) është mbajtur konferenca e tetë "FSK-ja dhe partnerët"

Kosova kërkon përkrahjen e faktorit ndërkombëtar për transformimin e FSK-së

Kryeministri Ramush Haradinaj dhe ministri i FSK-së, Rrustem Berisha, kanë kërkuar të enjten ndihmën e partnerëve ndërkombëtarë për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës që pjesë e këtij procesi të jetë edhe Lista Serbe. "Përkushtimi ynë është që edhe në të ardhmen ta vazhdojmë përgatitjen e FSK-së për tranzicion. Kërkojmë mbështetjen dhe ndihmën e juaj që edhe Lista Serbe të jetë pjesë e këtij procesi", është shprehur ministri i FSK-së, Rrustem Berisha

EPOKA E RE **Faton DERMAKU**

Prishtinë, 26 prill - Në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK) ka filluar punimet konferenca dyditore "FSK-ja dhe partnerët" me pjesëmarrje të ambasadorëve dhe atasheve ushtarakë të shteteve partnere. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka shprehur falënderim për miqtë ndërkombëtarë të cilët në vazhdimësi kanë ndihmuar Kosovën dhe FSK-në. "Jua kemi borxh të jemi partnerë me ju, sepse na keni ndihmuar në kohë kritike që të jemi këtu ku jemi sot", është shprehur Haradinaj në hapjen e punimeve të kësaj konference. Ai ka thënë se FSK-ja është shtëpia e të gjithëve. "Forca e Sigurisë së Kosovës reflekton të vërtetën e Kosovës dhe kjo e vërtetë është që të gjithë ne, çdo qytetar i këtij vendi, të ndihet si në shtëpinë e tij, qoftë shqiptar, serb, turk, rom, ashkali, egjiptian, boshnjak. Sot jemi në një institucion, që është shtëpia e të gjithëve. Aspirata jonë është që t'i bashkohemi familjes së Aleancës Veriatlantike dhe t'i kontribuojmë paqes", është shprehur kryeministri Haradinaj, duke theksuar se tranzicioni i Forcës së Sigurisë dhe mandati kushtetues i saj nuk do të ndërrojnë themelin e shtetit

tonë dhe misionin e vizionin e shoqërisë sonë. Haradinaj ka thënë se Ushtria e Kosovës do të jetë partnere e besueshme dhe e qëndrueshme e NATO-s. Ministri i FSK-së, Rrustem Berisha, fillimisht ka falënderuar të gjithë partnerët e FSK-së për kontributin dhe mbështetjen e vazhdueshme dhënë për arritjen e synimeve të Ministrisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ministri Berisha ka thënë se konferenca "FSK-ja dhe partnerët" ka për qëllim harmonizimin e aktiviteteve me partnerët, me synim të mbështetjes së nevojave të FSK-së si dhe koordinimin e përpjekjeve të përbashkëta në rrugëtimin e Republikës së Kosovës drejt integriteteve euroatlantike. "Duke i paraqitur para jush kërkesat dhe nevojat tona, në mënyrë që ta shfrytëzojmë në mënyrë sa më racionale angazhimin tonë për ngritjen e kapaciteteve të FSK-së, ne kemi për qëllim rritjen e ndërveprueshmërisë së FSK-së me ushtritë e vendeve partnere dhe atyre të NATO-s", ka deklaruar Berisha, duke shtuar se gjatë kësaj konference MFSK-ja do të prezantojë para atasheve ushtarakë dhe diplomatëve, të arriturat, sfidat me të cilat presin të ballafaqohen, nevojat dhe kërkesat për vazhdimin e



mbështetjes nga partnerët edhe në të ardhmen. Ministri Berisha, pasi ka përmendur disa prej të arriturave kryesore të institucionit, si rritja e besueshmërisë në veri të vendit, integrimi me sukses i komunitetave joshumicë, barazia gjinore, bashkëpunimi me ekipin këshillues dhe ndërlidhës të NATO-s për MFSK/FSK (NALT) dhe vendet partnere, i ka numëruar edhe disa prej synimeve për të ardhmen, sikurse anëtarësimin e plotë në iniciativat rajonale, qasjen adekuate për vendosjen e kontakteve me vendet që ende nuk e kanë njohur Kosovën dhe partnerëve të tjerë ndërkombëtarë. "Ne si FSK kemi bërë përpjekje të vazhdueshme që procesi i transformimit të ndodhë përmes ndryshimeve kushtetuese duke qenë të përkushtuar që pjesë e këtij procesi të jenë të gjitha komunitetet joshumicë, në këtë rast dhe komuniteti serb", ka

thënë Berisha, duke theksuar se MFSK-ja i ka realizuar të gjitha aktivitetet e parapara sipas planit të veprimit, ndërsa pjesën tjetër do ta realizojë pas marrjes së vendimit për transformim. Në fund të fjalës së tij, ministri Rrustem Berisha ka pohuar se është i përkushtuar që edhe në të ardhmen të vazhdojë përgatitjen e FSK-së për tranzicion, duke kërkuar edhe ndihmën dhe mbështetjen e vendeve partnere në këtë proces. "Përkushtimi ynë është që edhe në të ardhmen ta vazhdojmë përgatitjen e FSK-së për tranzicion. Kërkojmë mbështetjen dhe ndihmën e juaj që edhe Lista Serbe të jetë pjesë e këtij procesi", është shprehur ministri Berisha. Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtnant Rrahman Rama, ka thënë se pa mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë Forca e Sigurisë

së Kosovës nuk do të ishte këtu ku është sot. "Në organizatën tonë kultivojmë tri principe, atë të udhëheqjes, marrëdhënies dhe miqësisë. Ne sot këtu, së bashku me atashetë e vendeve mike, kemi një ditë të gjatë dhe do t'i koordinojmë të gjitha aktivitetet tona, kërkesat dhe nevojat për të ardhmen", ka thënë Rama. Në këtë konferencë ishin të pranishëm edhe zëvendësministri i FSK-së, Burim Ramadani dhe Agim Çeku, komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Salvatori Cuoci, si dhe ambasadorë të vendeve mike dhe partnere, atashetë ushtarakë të akredituar për Kosovë nga Shqipëria, Belgjika, Bullgaria, Kanadaja, Republika e Çekisë, e Francës, e Hungarisë, e Italisë, e Maqedonisë, e Malit të Zi, e Turqisë, e Mbretërisë së Bashkuar dhe e ShBA-së.

MSh-ja ia bartë Odës së Mjekëve kompetencat për licencim

PRISHTINË, 26 PRILL (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, i ka dorëzuar të enjten kryetarit të Odës së Mjekëve të Kosovës (OMK), Pleurat Sejdiu, vendimin për bartjen e kompetencave për licencimin, rilicencimin e profesionistëve shëndetësorë vendorë dhe edukimin e vazhdueshëm mjekësorë nga MSh të OMK-ja. "Kjo është një ditë e shënuar e cila tregon se Oda e Mjekëve të Kosovës ka krijuar një dinamizëm të ri të punës dhe me trupat e saj do të jetë pjesë e reformës shëndetësore, duke u bërë bartëse e disa ndryshimeve



të rëndësishme", ka thënë ministri Ismaili. Ai ka pohuar se Ministria e Shëndetësisë do ta vazhdojë me bartjen e kompe-

tencave të tjera tek Oda e Mjekëve, prej së cilës pret një angazhim dinamik në funksion të reformës dhe ndryshimeve në shëndetësi, duke i bërë profesionistët pjesë aktive të këtij procesi, përmes fuqizimit të rolit të tyre, rritjes së transparencës dhe luftimit të deformiteteve të ndryshme në sektorë. Kryetari i Odës së Mjekëve të Kosovës, Pleurat Sejdiu, ka theksuar se me bartjen e këtyre kompetencave po hapet një faqe e re e bashkëpunimit dhe avancimit të rolit të mjekëve në sistemin shëndetësor falë një

filozofie të re të një menaxhimi të ri të Ministrisë së Shëndetësisë dhe ministrit aktual. Ai ka thënë se OMK-ja do të jetë mbështetëse e ndryshimeve në shëndetësinë e Kosovës përmes ushtrimit me përgjegjësi të kompetencave të veta. Në ceremoninë e bartjes së këtyre kompetencave, në mënyrë simbolike u ndanë edhe kartelat e para të anëtarësisë për anëtarë të Odës së Mjekëve, duke përfshirë disa mjekë të gjeneratave të vjetra, për mjekun më të re në databazën e anëtarësisë së OMK-së, mjekë nga Forca e Sigurisë së Kosovës dhe Policia e Kosovës.

Ministri Hasani: Po luftojmë falsifikimin dhe piraterinë

EPOKA E RE A. MAVRAJ

PRISHTINË, 26 PRILL - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, ka thënë se po punon për forcimin e pronës intelektuale si prioritet i ministrisë dhe si obligim i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA). Ai ka thënë të enjten se bashkë me institucionet e tjera po e luftojnë piraterinë dhe falsifikimin. "Falsifikimit të produkteve, piraterisë dhe dukuri të ngjashme që janë preokupim dhe problem i shumë vendeve të botës, prandaj është e një rëndësie të veçantë që këto dukuri negative të luftohen dhe në Kosovë", ka thënë Hasani në konferencën për Ditën Botërore të Pronësisë Intelektuale.

Ai ka shtuar se pronësia intelektuale ka një rëndësi të veçantë ekonomike për biznesin dhe vlerësohet se 70 deri në 80 për qind e aseteve të një kompanie në vendet me ekonomi të bazuar në dije përbëhet nga pasuria jofizike



ose kapitali intelektual. "Ne do të jemi të fokusuar në ngritjen e sistemit të pronës intelektuale dhe miratimin e gjithë infrastrukturës ligjore të nevojshme, si dhe në ngritjen dhe fuqizimin e mëtejme të infrastrukturës institucionale duke rritur kapacitetet e tyre fizike dhe buxhetore për ta ndaluar luftimin e dukurive negative të përdorimit të paautorizuar të markës tregtare; prodhimit, eksportimit dhe shitjes së patenteve pa licencë; falsifikimit të pro-

dukteve; piraterisë dhe dukuri të ngjashme që shqetësojnë gjithë botën. Prandaj është e një rëndësie të veçantë që këto dukuri negative të luftohen dhe në Kosovë", ka thënë Hasani. Ai ka bërë me dije se Agjencia e Pronësisë Industriale gjatë vitit kalendarik të punës ka kryer apo printuar 9 900 dokumente dalëse që janë komunikime të drejtpërdrejta me aplikuesit dhe janë kryer mbi 29 000 procedura të brendshme.

Zvicra ofron përkrahje për menaxhimin e resurseve ujore

PRISHTINË, 26 PRILL (ER) - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Albena Reshitaj, ka pritur të enjten në takim përfaqësuesit e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim - SDC, në udhëheqje të ekspertit të resurseve ujore Peter Koenig. Pasi ka falënderuar për mbështetjen që Qeveria zvicerane po jep në fushën e ujërave në Kosovë, ministrja Reshitaj ka prezantuar prioritetet e saj, duke filluar me ngritjen e kapaciteteve humane brenda Autoritetit Rregullativ të Pëlligjeve Lumore, shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit në tërë territorin e Kosovës, menaxhimin e duhur të burimeve ujore dhe riparimin e rrjetit ekzistues të ujësjellësit. Ministrja Reshitaj ka paraqitur edhe iniciativën e saj për t'i zëvendësuar



gypat e ujësjellësit me përbërje të asbestit, të cilët, sipas ministres, janë shumë të rrezikshëm dhe rrezikojnë shëndetin e mirëqenien e qytetarëve të Kosovës. Ndërkaq eksperti zviceran Peter Koenig ka premtuar se do ta përkrahë ministrën Reshitaj për

realizimin e projekteve që ka iniciuar ajo duke përfshirë edhe përkrahjen për studentët e hidroteknikës në Universitetin e Prishtinës në zgjerimin e njohurive të tyre praktike si dhe në vetëdijimin e qytetarëve për menaxhimin e duhur të ujit.

Telekomi fiton kontestin gjyqësor me AXOS-in në Gjykatën e Arbitrazhit

PRISHTINË, 26 PRILL - Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit ka vendosur në favor të Postës dhe Telekomit të Kosovës në rastin gjyqësor me kompaninë "Axos". "Klan Kosova" ka raportuar se vendimi lidhur me këtë kontest gjyqësor do të bëhet publik më 4 maj të këtij viti. Procesi i privatizimit të Postës dhe Telekomit të Kosovës kishte nisur në vitin 2010. Por tre vjet më vonë, në prillin e vitit 2013, "Axos" ishte shpallur fituese pasi kishte ofruar 277 mil-

ionë euro për blerjen e 75 për qind të aksioneve në "Vala" e Telekom. Privatizimi i PTK-së nuk kishte ndodhur. Kuvendi i Kosovës nuk ia pati dhënë "dritën jeshile" raportit të Qeverisë për shitjen e PTK-së pasi ishte opozita ajo që e kundërshtonte fort këtë proces duke bojkotuar disa herë edhe seancat. Pasi ishte marrë vendimi që ky proces të ndalet, "Axos" që është kompani gjermane kishte paralajmëruar padinë. Ministri i Zhvillimit Ekonomik që

ishite në atë qeverisje, Fadil Ismajli, pati deklaruar se asnjë kompanisë "Axos". "ACP Axos Capital GmbH" kishte bërë padinë më 4 qershor të vitit 2015 në Gjykatën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve Investive (ICSID). Qeveria e Kosovës më 2 shtator të po këtij viti ndau 200 mijë euro për mbrojtje. Kompania "Patton Boggs" ishte përfaqësuesja e saj ligjore për zgjidhjen e këtij kontesti.



Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës - BSPK
bënë thirrje për protestë të martën më 1 maj në orën 11:00 te Sheshi Zahir Pajaziti. BSPK fton të gjithë anëtarët sindikal, punëtorët e sektorit privat dhe publik, studentët, të gjithë qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile që të bashkohen në mbrojtjen e të drejtave sociale.

1 MAJ FTESË PËR PROTESTË!

Kërkesat kryesore të protestës janë:

- ✓ Zbatimi i ligjeve dhe kontratës kolektive
- ✓ Siguria dhe shëndeti në punë
- ✓ Të njihet përvoja e punës për vitet 1990-1999
- ✓ Sigurim shëndetësor



BPSK-ja bën thirrje për protestë më 1 maj

PRISHTINË, 26 PRILL - Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) u ka bërë thirrje punëtorëve që më 1 maj, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Punës, të dalin të protestojnë. "Punëtorët në Kosovë përballen në baza ditore me padrejtësi dhe me moszbatim të ligjit, andaj është koha që të gjithë së bashku ta ngrehim zërin në Ditën Ndërkombëtare të Punës - 1 Maj. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës u ka bërë thirrje të gjithë atyre që përballen me mohim të së drejtës për punë, mohim për pagë të dinjitetshme, siguri dhe shëndet në punë t'i bashkohen protestës gjatë Ditës Ndërkombëtare të Punës - 1 Maj", është thënë në njoftimin e

BSPK-së. Sipas BSPK-së, protesta do të fillojë në orën 11:00 tek Sheshi "Zahir Pajaziti" për të vazhduar drejt Teatrit Kombëtar, tek ndërtesa e Qeverisë së Kosovës. BSPK-ja i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës që t'i zbatojë ligjet për të gjithë pa dallim sektori publik e privat dhe pa dallim gjinie. Sipas BSPK-së, Qeveria duhet ta zbatojë kontratën kolektive, të garantojë siguri dhe shëndet në punë, ta njohë përvojën e punës për vitet '90-'99, ta aplikojë sigurimin shëndetësor, ta aprovojë pagën minimale dhe të sigurojë punë dhe jetë të dinjitetshme. "Numri sa më i madh i protestuesve e bënë edhe thirrjen drejt Qeverisë më të fuqishme. Bashkohu edhe ti", është thënë në njoftimin e BSPK-së.



Nderohet komandant Shemi dhe bashkëluftëtarët e tij

MITROVICË, 26 PRILL (ER) - Në 19-vjetorin e vrasjes nga forcat kriminale serbe, në Mitrovicë është përkujtuar heroi i Kosovës, Shemi Ahmeti, i njohur si komandant Shemi, si dhe bashkëluftëtarët e tij që kanë rënë në të njëjtën ditë në betejën e Melenicës, më 26 prill në vitin 1999, Enver Musa, Shemi Isrefi, Faruk Beqiri, Sokol Preteni, Esat Mehulli, Qazim Cimili.

Në varrezat e dëshmorëve në Shipol, kryetari i komunës, Agim Bahtiri, me bashkëpunëtorë, kryetari i Organizatës të Veteranëve të Luftës së UÇK-së, kryetari i Shoqatës të Veteranëve të Luftës së UÇK-së

në Mitrovicë, Rafet Ibishi, ish-komandanti i Brigadës 141 "Mehë Uka", të ZO Shalë e Bajgorës, kolonel Hysni Ahmeti, familjarë të heroit dhe shumë bashkëluftëtarë të tij e mysafirë të tjerë, kanë nderuar komandantin Shemi Ahmeti dhe dëshmorët e tjerë që ranë bashkë me të në të njëjtën ditë. Kryetari i Organizatës të Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Guçati, ka thënë se dëshmorët meritojnë respektin e të gjithëve. "Këto ditë janë të dhimbshme për familjarët e dëshmorëve, për bashkëluftëtarët e tyre, por edhe për të gjithë ata që e duan lirinë", ka thënë Guçati.



Nis asfaltimi i rrugës Junik - Nivokaz

PRISHTINË, 26 PRILL (ER) - Në prani të shumë qytetarëve të fshatit Nivokaz të Komunës së Junikut dhe zyrtarëve komunalë ka filluar të enjten asfaltimi i rrugës që lidhë këtë komunë me fshatin Nivokaz. Kryetari i Komunës së Junikut, Agron Kuçi, u ka premtuar banorëve të fshatit Nivokaz se, sipas mundësive ligjore, do të

bëjë investime që ndikojnë në ngritjen e mirëqenies së tyre dhe të banorëve të fshatrave të tjera përreth Komunës së Junikut. Kuçi ka thënë se një prioritetet tjetër është hapja dhe trasimi i rrugës për beshkë të Nivokazit ku do të mundësojë frekuentimin e lehtë të banorëve të fshatit Nivokaz në beshkën e tyre.



700 të rinj i bashkohen PDK-së në Prizren

PRIZREN, 26 PRILL (ER) - Dega e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Prizren ka bërë me dije se kësaj partie i janë bashkuar mbi 700 të rinj dhe të reja në kuadër të procesit të brendshëm zgjedhor. "Procesi zgjedhor i cili është duke u zhvilluar në strukturat e PDK-së në Prizren, i filluar me Rininë Demokratike të Kosovës, po ecën sipas planifikimeve dhe dinamikës së paraparë. Zgjedhjet të cilat po zhvillohen në Rininë Demokratike po sjellin një frymë të re me ide të

reja, me djem dhe vajza të reja, me shumë energji dhe motiv për të kontribuar në radhët e PDK-së. Të rinjtë, gjithandej të Komunës së Prizrenit, dita-ditës po i bashkohen Dekadës së Re. Vullneti dhe energjia e tyre po i sjellin PDK-së dhe vendit tonë më shumë zhvillim dhe integritet, duke besuar në Partinë Demokratike të Kosovës", është theksuar në njoftimin e PDK-së. Kjo parti ka vlerësuar se ky proces zgjedhor është procesi i parë i mirëfilltë gjithëpërfshirës, i grupmoshave prej 16 deri 25

vjeç, i cili ka ofruar rreth vetes qindra të rinj të qytetit në radhët e strukturave të zgjedhura të RDK-së. "Dekada e Re e ka të vulosur fatin e vet tek të rinjtë, të cilët i ftojme t'i bashkëngjiten këtij procesi dhe ta japin kontributin e tyre në ndërtimin e shtetit të Kosovës në dekadën e dytë të pavarësisë. Deri më tani në kuadër të këtij procesi zgjedhor PDK-së në Degën e Prizrenit i janë bashkangjitur rreth 700 të rinj dhe të reja dhe ky numër dita-ditës po rritet ende", është thënë në njoftimin e PDK-së.

Abrashi pret vendim të drejtë nga Kushtetuesja në garën për Prishtinën

PRISHTINË, 26 PRILL (ER) - Ish-kandidati i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për kryetar të Prishtinës, Arban Abrashi, ka drejtuar kritika ndaj qeverisjes komunale të drejtuar nga Shpend Ahmeti. Abrashi ka përmendur edhe tremujorin e parë të këtij viti të kompanisë "Pastrimi", duke thënë se ajo ka dështuar pasi është marrë nën menaxhim nga komuna. "Derisa vitin e kaluar në tremujorin e njëjtë kompania 'Pastrimi' ka inkasuar rreth 615 mijë euro për tre muaj, këtë vit komuna, pasi e ka marrë këtë kompetencë, ka arritur t'i inkasojë vetëm 133 mijë euro. Po flasim për rreth 400 mijë euro më pak", ka thënë Abrashi në një konferencë për medie të enjten. Ai ka thënë se përderisa të hyrat kanë shënuar rënie, shpenzimet për mallra dhe shërbime janë



arritur. Abrashi, i cili me një përqindje të vogël kishte humbur nga Ahmeti në balotazhin e nëntorit të vitit të kaluar, shpreson se Gjykata Kushtetuese do të vërtetojë se në zgjedhjet për Prishtinën janë shkelur të drejtat e tyre. "Ju e dini ankesën tonë në Gjykatë

Kushtetuese dhe në këtë drejtim presim një vendim të drejtë, sepse mendojmë se të drejtat tona kushtetuese janë shkelur. Shpresojmë që Kushtetuesja do ta vërtetojë shkeljen e të drejtave kushtetuese dhe të kemi një vendim meritore nga ajo", ka thënë Abrashi.

KEMI POLITIKANË GJENIALË, TË KALAVESHUR ME PLATFORMA TË TREDHURA!



**Behxhet Sh. SHALA -
BAJGORA**

Platforma, parolle, parolle... Ishte një hit muzikor i kënduar nga Rita Pavone në gjuhën italiane para 30-40 vjetësh që quhej, parolle, parolle, parolle (fjalë, fjalë, fjalë...) e që lidhej me dashuri të papërmbyshur dhe se përfundon vetëm me fjalë. Në atë kohë disa aktorë që pretendojnë se merren me politikë në Kosovë, bënin hapat e parë duke u mbajtur për bisht të qenit të shtëpisë i cili, për shkak të lodhjes dhe moshës, nuk shërbente më si ruajtës i shtëpisë, por si ndihmës për fëmijët e vegjël të shtëpisë, qoftë për t'i bërë hapat e parë, qoftë për t'u argëtuar sepse, në atë kohë nuk kishte lodra sikur sot. E as kopshte për fëmijë sikur që nuk kishte as kopshte apo

hotele për qenushë ku disa politikanë të matrapazuar kosovarë i dërgojnë "të dashurit" e tyre, për pushim dhe relaksim nga lodhja e të jetuarit në mesin e njerëzve. Është një thënie tjetër që lidhet me mjekësinë konservative dhe alternative ku thuhet se: "Ku ka shumë mami gjatë lindjes, fëmija lind me të meta". Gjithashtu, gjatë kohës së komunizmit socialist në ish-Jugosllavi, ku shqiptarëve që e donin lirinë, disa shqipfolës, bijtë dhe bijat e të cilëve sot vrapojnë e kthjellin në Kosovë, duke qenë njerëz kryesorë (si këshilltarë vendimmarrës) në Presidencë, Kuvend dhe Qeveri ua kanë kaptë nëntëqind mijë nëna dhe baba, e kishin një moto të trashëguar nga jugosllavët: "Nëse nuk doni të bëni asgjë, mbani sa më shumë mbledhje dhe prodhoni sa më shumë dokumente". Këta tre shembuj vlejnjë vetëm për injorantë, shtete të pakonsoliduara e që thirren në një demokraci të qëndrueshme siç ishte Italia e Rita Pavones, ish-Jugosllavia e kriminelit Tito që aq shumë e kanë dashur disa persona me ndikim sot në Kosovë sikur që

është Azem Bejta i komunizmit, dhe bijtë dhe bijat politike të kriminelit Tito, "humanistit Millosheviq", kohën e të cilëve duan ta kthejnë sot. Për fat të mirë, Kosova ka pasur dhe ka politikanë patriotë që kanë luftuar për këtë vend dhe që luftojnë edhe sot, deri në euron e fundit që e marrin, si kompensim për të kaluarën përmes mbajtjes së pushtetit dhe postit duke e dëmtuar jashtëzakonisht shumë Kosovën në kohën kur është dashur ta bëjnë të kundërtën. Mbajtja e pushtetit për një kohë të gjatë i prodhon tiraninë, dhunën, anarkinë e konsoliduar dhe të kontrolluar e që për rezultat e ka koncentrimin e tërë pasurisë te një rreth i ngushtë, te një person i cili është në krye të oligarkisë, ndërkohë që pjesa dërrmuese e qytetarëve e pëson. Krijohet një perandori e kriminit dhe zhatvajes e cila domosdoshmërisht shembet dhe përfundon tragjikisht për kryezaptuesin dhe lakenjtë rreth tij. Nuk ka shembull në botë që një keqbërës apo dhunues i vullnetit të ketë përfunduar mirë sepse, ose është tërhequr zvarrë, ose është

detyruar të jetojë i syrgjynosur, në një vend tjetër. Kjo është situata sot në Kosovë ku i kemi të gjitha dhe nuk kemi asgjë. Nuk njihet vend në botë që aq lehtë dhe aq paturpshëm, për interes personal (material) dhe ruajtje të lëkurës, e shpërdoron kapitalin politik të një vendi dhe ardhmërinë sikur që po ndodhë në Kosovë, nga individë të papërgjegjshëm, sikur që dikur bëhej nga krahu pacifist (kapitullues) dhe sot nga një pjesë e krahut të luftës (dezertorë të qëllimeve dhe dhunues të idealit)! Sot në Kosovë kemi prodhim të shtuar të platformave politike, dokumenteve, konferencave, tryezave politike nga injorantët politikë, debateve të organizuara nga pjesa më e kriminalizuar e mendermethënë shoqërisë civile e që pretendojnë të merren me çështje të mëdha pasi ato të "voglat" e që janë të rëndësishme për qytetarin (ulja e papunësisë, mënjanimi i varfërisë, shkollimi i shëndoshë dhe cilësorë, mbrojtja shëndetësore profesionale dhe e pakorruptuar, shërbimet e tjera publike në përputhje me standardet më demokratike) moti i kanë

zgjidhur e që as Gaboni, vendi me një demokraci ndër më të zhvilluarat në botë (mike e Hashimit dhe Erdoganit për trajtim të gylenistëve) dhe me një ekonomi jashtëzakonisht të përparuar me të ardhura për kokë banori prej 250 \$ në vit nuk e ka arritur këtë sukses! Me të drejtë presidenti ynë post-historik, në takimet e nivelit shumë të lartë, ku për arsye të jorelevancës që paraqesin për proceset globale botërore nuk ftohen Trampi, kancelarja Merkel, Makroni i Francës, Putini i Rusisë dhe Kimi i Koresë Veriore sikur dhe të tjerët, por marrin pjesë politikanët e pensionuar dhe të harruar, analistë të dekluar që për një honorar të bëjnë më të rëndësishëm se të gjithë fituesit e Çmimit Nobel dhe matrapazë shëtitës dhe cirkuantë të tjerë parashikues, deklararon se Kosova është storie (përrallë) e suksesit. Pajtohem plotësisht me këtë nëse e ka parasysh statusin personal, të të afërmeve të tij dhe armatës së llaskuqëve që lehin për të, sipas refleksit të Pavlovit në mënyrë automatike. Kosova nuk është regjim i suksesit, por është

tregim i zhgënjimit dhe injorancës, të humbjes së perspektivës dhe shkatërrimit të embrionit të të bërit shtet. Qofsha i gabuar dhe lehtësisht mund edhe të gaboj sepse unë nuk e kam trurin e presidentit dhe as të rrogëtarit më të lodhtë të tij shkaku se, edhe kur kam shkruar shkrime e kam lutur Bacën Adem të shkruaj në emrin tim, kurse sot e lus Fistek Leshin. Pra, i lexoj shkrimet që dikush i shkruan për mua e që është shumë më pak e dëmshme se, p. sh., kur dikush e shkruan një libër për ty, një platformë politike që e shkërdhenë shtetin apo statutin e një OJQ-je siç është Asociacioni i Komunave të Serbisë në Kosovë, për të cilën e tërë bota është hallakatur duke e caktuar edhe afatin se kur do të themelohet. Unë jam realist, idealist (budalla) dhe besoj skajshëm në fjalët e presidentit post - historik, Ekselencës z. Hashim Thaçi, se ky Asociacion do të jetë vetëm një OJQ. Disa miq po më konsiderojnë si të marrë për besimin aq të madh dhe të paluhatshtëm që e kam te zotëri Thaçi dhe nuk po u besoj miqve të Kosovës që deklarojnë se Asociacioni do të formohet sipas ligjeve të Kosovës, por se do të ketë kompetenca ekzekutive. Disi si ajo - ai fituesja - fituesi e-i Eurovisionit Vurst, femër me mjekër të burrit, por pa e ditur statusin brenda brekëve të saj apo atij. Ne po shqetësohemi pa nevojë dhe po krijojmë panik për disa gjëra të vogla dhe të parëndësishme për një shtet. Asociacioni, si një OJQ që është, më së shumti që mund të bëjë është se mund ta marrë veriu e Kosovës dhe ta bëjë pjesë të Serbisë, nuk do të lejojë të formohet ushtria e Kosovës, do ta minojë punën e institucioneve të Kosovës, do të kontribuojë në jostabilitetin e përhershëm të Kosovës, do t'i inkurajojë serbët e Kosovës që të marrin paga nga Kosova, por që rrymën, ujin, mbeturinat dhe shërbimet e tjera t'ia paguajnë shtetit të tyre, Serbisë kriminale. Po a nuk e kemi këtë gjendje edhe sot në Kosovë a?! Ju lutem të më demantoni në njërin nga pohimet në këtë shkrim për të cilin nuk marr përgjegjësi për faktin se publikisht po e pranoj se nuk i shkruaj unë, por këtë e bëjnë të tjerët për mua. Unë vetëm bëj përpjekje t'i fryj koçet (mbetjet e tyre) në emër të të tjerëve. Po a nuk e bën këtë edhe presidenti ynë madhështor?! Një mik imi më tha se Presidenti yt (e pranoj se është imi), pas Martin Shkrelit është shqiptari më i urreyer në botë: Nuk pajtohem, absolutisht nuk pajtohem, i thashë

atij që shkruan në emrin tim, jo që nuk e urrej, por theksoj me shkronja të mëdha dhe në vend të dukshëm se E DUA SHUUUUUUUMË. Jam njëfarë kalkulanti dhe mashtruesi i vogël, ju lutem më ndjeni për këtë! Ngecja në shkollim, mosha, gjendja shëndetësore dhe problemet mendore duhet të merren si rrethana lehtësuese në gjykimin tuaj, lexues të nderuar!

Tash për platformat dhe dokumentet përalllore të tregdhura:

Nuk ka sot person në Kosovë e që nuk është marrë me gjëra të mëdha që janë interes i shtetit dhe popullit. Askush nuk merret me vogëlsira e pse të bëj përrashtim e të merrem vetëm unë! Ata që, në të kaluarën, me mish, mendje, shpirt, me dajak dhe me mjete të tjera demokratike kanë punuar kundër Kosovës dhe shqiptarëve, sot ofrojnë receta të gastronomisë politike dhe kombëtare se si duhet të bëhet shteti. Ata që dikur e kanë penguar luftën çlirimtare me të gjitha mjetet, sot duan ta përvetësojnë këtë luftë duke deklaruar paturpësisht se 70 % e luftëtarëve të UÇK-së paskan qenë nga radhët e partisë (hiq përrashtimeve) e cila ka bërë çmos që të dështojë lufta dhe të mos ketë luftë, por se lirinë do ta fitojnë duke flladitur koçet nën mriazin e Serbisë! Paturpësisht, bashkëpunëtorët e UDB-së dhe KOS-t të Serbisë i bëjnë heronj të Kosovës (dhe i kanë bërë) krejt në sajë të kontributit të një pjese të krahut të kriminalizuar dhe të korruptuar të luftës, të cilët nuk e lanë pa i bërë të gjitha të zezat, pas përfundimit të luftës. Kjo është temë për një shkrim tjetër. Platformat që sot po lansohen nga individë, parti, institucione dhe të tjerë për "çështje madhore të shtetit dhe kombit" janë flluska sapuni dhe ambalazhim i një dështimi të deritashëm. Këto platforma dhe dokumente për një konsensus politik dhe kombëtar, për "çështje madhore të shtetit dhe kombit", në kohën kur nuk i gjeni dy politikanë në Kosovë që nuk duan t'ia fusin tjetrit prapa shpinës, është mashtrim dhe përpjekje për legalizim të gjendjes ekzistuese, pas zhvillimeve - dëmeve jashtëzakonisht dhe mbase të riparueshme që i kanë bërë Kosovës. Këto janë përpjekje që të fuqizohet dhe përligjet një marrëveshje, sigurisht e arritur midis Vuçiqit dhe Thaçit dhe për të cilën duhet kohë përshtatjeje sikur edhe disiplinim i atyre që e kundërshtojnë, si në Serbi, ashtu edhe në Kosovë. Realisht, Serbia, pasi e humbi Kosovën, tash, falë faktorit

ndërkombëtar dhe injorantëve politikë në Kosovë, po kthehet fuqishëm si lojtar vendimmarrës për fatin dhe ardhmërinë e Kosovës. Këto platforma, pa përjashtime, i ngajnë një kondom me afat të skaduar apo të shqyer, që në vend të sigurojnë mbrojtje nga një shtatzëni e padëshiruar, vetëm sa e shtojnë numrin e të padëshirueshmeve. Këto platforma, në vend se ta mbrojnë vendin, qytetarin dhe ardhmërinë, si kondomët e shqyer, po e vazhdojnë dëmtimin e vendit përmes fuqizimit të atyre që më së shumti e kanë dëmtuar Kosovën. E keni lexuar se një dëmtuese dhe mashtruese ordinere, që e ka bërë m.t në të gjitha anët, tash po na alarmon duke na treguar se çfarë qëllimesh paska Serbia në Kosovë. Një mashtruese ordinere, pasi ka mbetur askund, po bën përpjekje të na këshillojë për rreziqet, ndërkohë që nuk ka lënë rrenë apo mashtrim pa përdorur për t'i arsyetuar poshtërsitë që i ka bërë duke zbatuar urdhra politikë! Këto platforma duan që Hashimin ta bëjnë Faraon të bisedimeve me Serbinë duke ia shtuar në mbështjellës prej të gjitha subjekteve politike dhe shoqërisë civile, për t'ia mbuluar lakuriqësinë e dëmeve që janë shkaktuar deri më tani dhe për ta rehabilituar atë. Natyrisht se në bisedimet me Serbinë e Vuçiqit duhet të jetë ekuivalenti politik nga Kosova e që aktualisht është personi me emrin Hashim të cilin, e thashë më lart, se e dua shumë dhe se i besoj shumë, mirëpo nuk duhet të lejohet të bëjë ç'të dojë dhe ta llogarisë Kosovën si prostitutë ndaj së cilës do t'i shfryj epshet seksuale dhe të tjera duke përdorur platformat konsensuale, si kondom të shqyer, siç ka vepruar deri më tani. Kosova është dëmtuar shumë deri më tani dhe duhet të ndërpritet kjo gjendje ose, në të kundërtën, do ta humbë kuptimin jo vetëm si shtet, por edhe si shprehje gjeografike. Nuk mund ta vendosë Hashimi aktual dhe as hashimët potencialë për fatin tim dhe të fëmijëve të mi sipas taktit se si i çohet ai seni! Platformat e mirëfillta bëhen ndryshe, nëse e kanë seriozisht. Kështu, nga aktorët që e kanë sjellë Kosovën në këtë gjendje (jo të gjithë), nuk mund të pritet diçka mobilizuese përveç vazhdimit të stërkeqjes dhe në këtë kontekst nuk duhet të bëhen platforma që i japin kompetenca të pakufishme presidentit, por duhet të hartohen platforma që e kufizojnë apo pamundësojnë arbitraritetin e tij lidhur me fatin e Kosovës gjatë bisedimeve kre-

jtësisht të pabarabarta me Serbinë. Nëse dikush mendon se nën hijen e Hashimit ngjallet, mbijeton apo forcohet politikisht e ka shumë gabim; 10 minuta nën hijen e Hashimit të djegin më shumë se 20 orë nën diellin në shkretëtirën e Saharasë, pa pasur asnjë mbrojtje nga dielli. Pa asnjë dyshim Kosova nuk do të ndahet mirë pas përfundimit të bisedimeve me Serbinë. Me vetë faktin se keni pranuar të shkoni në bisedime me duar në xhepa dhe duke kruar koçet, të rrethuar me llaskuçë dhe hajdutë injorantë dhe se jeni mjaftuar me përfaqimet e përzemërta të shovinistit Vuçiq dhe kriminelit Daçiç si dhe me shkëmbimin e puthjeve me bukuroshen, bareshën Eshton, pa pasur asnjë cak apo afat, tregoni se ku jeni, prandaj e kemi atë që e kemi merituar. Bisedimet me shtetin me të cilin keni luftuar janë të pashmangshme, por bëhen vetëm pasi t'i keni sqaruar disa gjëra, pas të cilave krijohen kushtet për normalizim të marrëdhënieve e që përfundon me pajtim. Kështu, me brekë të lëshuara po ankohemi pse po na ngulin kur të duan dhe si të duan e që, përmes lotëve, e konsiderojmë si padrejtësi historike!

H+H, Hetemi dhe Hashimi:

Hashimin po e njohim të gjithë, madje po na shkojnë edhe të vjellat, si Ujëvarat e Mírushës nga kjo njohje. Hetem Ramadanin nuk e kanë njohur shumë përveç një grupi të vogël. Hashimi dhe Hetemi janë shokë, miq sikur që Hetemi është mik me Bacën Adem të cilin gati e shëroi duke e dërguar në Parajsë. Për fat të mirë, e ndërpreu shërimin. Edhe unë e njoh Hetën në sajë të Bacës dhe Rexhep Dalldurit, babait të Hetemit. Heta ka lexuar shumë, më shumë se 40 % të shqiptarëve nëse i bëni bashkë. Prandaj edhe Hashimi, si erudit që është dhe i lexuar, e ka bërë mik të ngushtë Hetemin. Unë, si i metë intelektualisht, kurrë nuk arrita ta bëj mik Hetemin sepse, si të tillë, nuk më pranon në mesin e vet. Eventualisht mund të më pranojë si pacient nëse vazhdon të më përkeqësohet gjendja e shëndetit mendor. Tash, Heta, si profesor dhe studiues i fizikës kuantike (për mua kjo shkencë është sikur Samsungu 9 për Napoleon Bonapartën) më duket se nuk po merret me raste sikur ky imi. Shpresoj, duke e parë universalitetin e Hetës për shërimin e të gjitha sëmundjeve, më vonë do të merret edhe me rastin tim, pasi t'i ketë shëruar të gjithë të

sëmurët. Tash shtrohet pyetja se a mund ta shërojë Hetemi Hashimin në planin politik, duke ia hartuar një platformë?! Sigurisht se po. Me flokët e gjata dhe një mjekër po më duket disi si Rasputini i cili e filloi karrierën në oborrin e Carit të Rusisë si shërues për të vazhduar pastaj si parashikues. Nuk e dëshiroj që Heta ta ketë fundin si Rasputini e as Hashimi fatin e Carit të Rusisë. Por asgjë nuk përjashtohet, qoftë edhe si mundësi apo ide. Kush do të besonte se Barcelona do ta pësonte aq keq nga Roma?! Vetëm sa fillova të mësohem me këtë katastrofë humanitare, si simpatizues i madh i Barcelonës, më erdhi goditja edhe më e madhe; në një pyetje bërë Liverpoolit, pas fitores brilante me 5 me 2 ndaj Romës, se a ka mundësi që Roma ta përmbysë rezultatin, përgjigjja ishte, si do të thoshte presidenti post-historik, Hashim Thaçi, e joshkëlqyer, pra këta të Liverpoolit thanë se kjo nuk mund të ndodhë në asnjë mënyrë sepse Liverpooli nuk është Barcelonë. Duro Behxhet, duro! Duroje Hashimin dhe tash duroje edhe Liverpoolin!

Hetem Ramadanin është universal, sikur ngjiteti universal, sikur helmi për asgjësimin e minjve dhe sikur Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut e Kombeve të Bashkuara. Nëse paska arritur ta pengojë nënshkrimin e Marrëveshjes së Rambujesë duke thënë se këta (Thaçi dhe bendi) kanë qenë të rinj dhe të paditur dhe se pas një darke që ua paska paguar i ka bindur kundër Rambujesë, le ta provojë edhe sot, ndonëse e kemi një situatë tjetër; të mashtruarit e Rambujesë janë bërë mashtrues të përkryer dhe e dërgojnë Hetën në darkë duke e lënë të uritur. Le të provojë Heta me ta, në fushën ku është dëshmuar, në fushën e fizikës kuantike, por pa hyrë në shifra se këta e lënë fjetur. Mund të angazhohet t'ua ulë sheqerin, t'ua rrisë vëllimin e koçeve dhe t'ua ngushtojë prapanicën kur duhet të marrin vendime konsensuale në interes të shtetit. T'ua rrisë guximin dhe zemrën, t'ua ndriçojë mendjen, t'i fusë në lavatriçen e larjes së mëkateve për ata që kanë mëkate. Nëse këto arrin t'i bëjë Hetem Ramadanin, do t'ia heq kapelën me nderim më të mëdha, në të kundërtën do t'i bashkëngjitem vlerësimit të Jusuf Ulajt që e akuzon për sharlatanizëm dhe rrënim të shëndetit të hallexhinjve përmes mashtrimit dhe keqpërdorimit të gjendjes dhe nevojave të tyre.

Zbulime të reja mbi vrasjen e Kennedyt

WASHINGTON, 26 PRILL - Në afro 55 vjet pas vrasjes së John Kennedyt teori të pafundme konsiparative kanë dalë për të shpjeguar se nga realisht presidenti i ShBA-së u qëllua, duke filluar nga kodrina e gjelbër në krahë. Pavarësisht prej arrestimit të Lee Harvey Oswald, e që provat e mëvonshme lidhnin plagën e Kennedyt me tipin e armës që Oswaldi kishte, skept-

tikët kanë propozuar se ka qenë edhe një qitës i dytë që qëndronte në kodrinë e gjelbër pranë rrugës ku po kalonte Kennedy.

Por tanimë një studim i ri mund t'i japë fund këtij debati.

Përlllogaritjet e reja, bazuar në pamjet filmike që regjistruan momentin e vrasjes, indikojnë se lëvizja misterioze e kokës së presidentit pasi u qëllua, një

detaj jetik për teorinë mbi kodrinë e gjelbër, ka qenë thjesht një efekt i zmbarsjes.

Hetimet e hollësishme tregojnë se përplasja e plumbit fatal në kokë ka sjellë menjëherë një kthim për inerci edhe një kthim të kokës prapa, duke shtuar prova të mëtejshme se Kennedy u qëllua nga pas, siç edhe autopsia zyrtare e asaj kohe tregoi.



Macroni nuk pret që Trumpi të mbetet në marrëveshjen me Iranin

Duke folur gati në fund të vizitës së tij treditëshe në Uashington, presidenti francez Emmanuel Macron tha se Trumpi do ta heqë qafe këtë marrëveshje për arsye të brendshme dhe për shkak të zotimeve në fushatë se do të tërhiqet nga ajo

PARIS, 26 PRILL - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, tha se nuk pret që presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, të vazhdojë ta respektojë marrëveshjen bërthamore me Iranin. Duke folur gati në fund të vizitës së tij treditëshe në Uashington, Macroni tha se Trumpi "do ta heqë qafe këtë marrëveshje për arsye të brendshme" dhe për shkak të zotimeve në fushatë se do të tërhiqet nga ajo.

Macroni kaloi orë të tëra me Trumpin gjatë vizitës së tij dhe për muaj të tërë ka bërë përpjekje ta bindë atë që të vazhdojë ta respektojë marrëveshjen e vitit 2015 midis Iranit dhe fuqive botërore, me të cilën Republika Islamike ka rënë dakord ta frenojë aktivitetin e saj bërthamor, në këmbim të lehtësimit të sanksioneve ndërkombëtare. Më 24 prill dy liderët thanë se

duan të krijojnë një marrëveshje të re, për t'i adresuar shqetësimet e Trumpit rreth programit të raketa balistike të Iranit dhe përfshirjes së tij në luftërat civile në Siri dhe Jemen.

Trumpi fillimisht tha se është i hapur për një marrëveshje të tillë, por ai vazhdoi të shprehë kundërshtime të fuqishme për marrëveshjen ekzistuese, duke e cilësuar atë si "të çmendur" dhe "qesharake". "Nuk kam informacione të brendshme se çfarë vendimi do të marrë Trumpi", u tha Macroni gazetarëve. "E dëgjoj atë që thotë presidenti Trump dhe më duket se ai nuk është i etur për ta mbrojtur marrëveshjen. Analiza racionale e të gjitha deklaratave të tij nuk më bën të mendoj se ai do të bëjë gjithçka për ta ruajtur atë", tha Macroni.

I pyetur nëse vendimi i mundshëm i Trumpit për t'u tërhequr



nga marrëveshja do të nënkuptonte dështim personal për të, Macroni tha se roli i tij "nuk është të përpikët ta bindë presidentin Trump që të tërhiqet nga premtimet e fushatës".

Kancelarja gjermane Angela Merkel pritet ta bëjë përpjekjen e fundit për ta bindur Trumpin që ta respektojë marrëveshjen, gjatë vizitës së saj në Uashington më

27 prill. Trumpi duhet të vendosë deri më 12 maj nëse do të vazhdojë t'i pushojë sanksionet amerikane kundër Teheranit, ashtu siç kërkohet me marrëveshje. Nëse jo, një gjë e tillë do të nënkuptonte shkelje të marrëveshjes dhe Irani është zotuar se do të përgjigjet, duke i hapur rrugë shpërbërjes së paktit.

Macroni i bëri komentet derisa një aeroplanmbajtës "Boeing" dorëzoi disa avionë udhëtarësh, të destinuar për Iranin, të blerës të tjerë, si rezultat i kërcënimeve të Trumpit për tërheqje nga marrëveshja bërthamore. Marrëveshja bërthamore me Iranin është nënshkruar në vitin 2015 nga ShBA-ja, Rusia, Kina, Britania, Franca dhe Gjermania.

NATO-ja i ofron ndihmë Afganistanit gjatë zgjedhjeve



BRUKSEL, 26 PRILL - NATO-ja thotë se mund të ofrojë siguri shtesë gjatë zgjedhjeve parlamentare në Afganistan, pas rritjes së sulmeve në vend, në prag të zgjedhjeve që do të mbahen në tetor. "Kontributi ynë kryesor është që të sigurohemi që zgjedhjet të mbahen në një ambient të sigurt dhe të vazhdojmë të ofrojmë mbështetje për forcat e sigurisë afgane,

duke i trajnuar ata, duke i këshilluar dhe duke i financuar", tha shefi i aleancës, Jens Stoltenberg.

Por, Stoltenbergu tha se përfshirja e NATO-s do të jetë e kufizuar. "Duke e thënë këtë, unë gjithashtu parashikoj një rol të kufizuar të forcave të NATO-s për të ndihmuar, në mënyrë që zgjedhjet të mbahen në një ambient të sigurt", tha ai.

Këto komente të Stoltenbergut vijnë pasi 60 persona u vranë në një sulm vetëvrasës në Kabul, jashtë një qendre për regjistrimin e votuesve më 22 prill. Talibanët kanë njoftuar se kanë nisur ofensivën e tyre vjetore të pranverës. Misioni i NATO-s ia ka dorëzuar përgjegjësitë për sigurinë në Afganistan autoriteteve vendore në fund të vitit 2014.

Ministrit kroat të Mbrojtjes nuk i lejohet ta vizitojë Serbinë

BEOGRAD, 26 PRILL - Autoritetet serbe ia kanë ndaluar hyrjen zëvendëskryeministrit, njëherësh ministrit të Mbrojtjes së Kroacisë, Damir Krstičević, në Serbi, deri në një njoftim të ardhshëm, pasi edhe Zagrebi zyrtar kishte vepruar ngjashëm fundjavën e kaluar. Tensionet në mes të Serbisë dhe Kroacisë janë rritur, pasi javën e

kaluar një delegacion kroat ndërpreu një vizitë në Serbi, pasi ligjvënësi ultra-nacionalist, Vojslav Sheshel, ofendoi ata dhe u përpoq që të shqyjejë flamurin kroat, transmeton "Reuters".

Të dielën ministri serb i Mbrojtjes, Aleksandar Vulin, nuk u lejua të vizitojë dhe të marrë pjesë në shërbimin përkujtues

për viktimat e Luftës së Dytë Botërore që ishin varur në kampin e përqendrimit në Jasenovac.

Serbia ka thënë se ka vendosur të mos lejojë vizitën e ministrit kroat në Serbi si masë reciprociteti. "Qeveria serbe beson se lëvizjet e Kroacisë janë në kundërshtim të frymës së bashkëpunimit fqinjë-

sor dhe respektit, që janë vlera bazike evropiane, ku përfshihet edhe liria e lëvizjes", thuhet në njoftim.

Të dielën Kroacia e akuzoi Vulinin se po minon sovranitetin e Kroacisë. Ai përmes një deklarate kishte thënë se Zagrebi nuk ka pasur të drejtë të vendosë nëse ai mund të vizitojë apo jo Kroacinë.



Ministri Gashi: Kosova ka bërë hapa të mëdhenj për të drejtat e autorit

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka thënë se pronësia intelektuale ka një rëndësi shumë të madhe për zhvillimin dhe avancimin e kulturës, shkencës dhe teknologjisë së vendit. Ai ka bërë me dije të enjten se Kosova ka bërë hapa të mëdhenj për aprovimin e legjislacionit modern për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta

Prishtinë, 26 prill (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka marrë pjesë të enjten në konferencën "Të drejtat pronësore intelektuale" e cila u organizua në Ditën Botërore të Pronësive Intelektuale, nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Dogana e Kosovës.

Motoja e konferencës për këtë vit është "Gratë në inovacion dhe kreativitet".

Ministri Gashi në fjalën e tij të rastit, në hapjen e kësaj konference, ka thënë se motoja e këtij viti "Gratë në inovacion dhe kreativitet" është moto e qëlluar dhe shumë e rëndësishme. "Të gjithë ne e kemi të qartë se gratë janë shumë kreative dhe inovative, dhe se gratë janë forca e ndryshimit. Institucionet duhet të punojnë që të përkrahin dhe nxisin sa më shumë që gratë të angazhohen në punë kreative dhe inovacion, kështu do ta siguronim kontributin e tyre të veçantë dhe të çmuar për kulturën dhe shoqërinë tonë", ka thënë ai.

Më tej, ministri Gashi ka thënë se pronësia intelektuale ka një rëndësi shumë të madhe për zhvillimin dhe avancimin e kulturës, shkencës dhe teknologjisë së vendit. "Ne jemi duke punuar për të krijuar një sistem të drejtës së autorit, ku krijuesit, performuesit dhe mbajtësit e tjerë të të

drejtave të autorit kompensohen dhe veprat e tyre trajtohen ndershtëm e me dinjitet, ky është edhe qëllimi i Ligjit për të drejtën e autorit dhe misioni i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Krijimtaria kulturore e mbrojtur me të drejtën e autorit sot është e ardhmja e trashëgimisë kulturore nesër, ne duhet t'i inkurajojmë dhe t'u japim nxitje krijuesve, performuesve dhe investitorëve, në punën dhe investimet e tyre", është shprehur Gashi.

Ai ka shtuar se Kosova ka bërë hapa të mëdhenj me aprovimin e legjislacionit modern për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. Gashi ka bërë me dije se kjo vlerësohet edhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2018.

Ministri Gashi foli edhe për arritjen e marrëveshjes për tarifën e përgjithshme në mes të Shoqatës për Menaxhim Kolektiv në fushën e Muzikës "APIK" dhe të përfaqësuesve të televizioneve dhe radiove. "Ky është hap historik për vendin, që siguron zbatim të drejtave të autorit dhe kompensim të autorëve, performuesve e producentëve. Së shpejti do të miratohet Strategjia e re Kundër Piraterisë, edhe Rregullorja për Kompensime të Veçanta, duke siguruar kështu vazhdimin e përbushjes së standardeve ndërkombëtare dhe jetësimin e



të drejtave të autorit", ka thënë Gashi.

Gjithashtu, ministri Gashi ka

theksuar se zbatimi i të drejtave të autorit mbetet sfidë e institucioneve të zbatimit të ligjit, të

vazhdojnë të marrin masa për të siguruar zbatim të drejtave të autorit. "Posaçërisht zbatimi i drejtave të autorit në ambientin digjital kërkon më shumë angazhim dhe bashkëpunim edhe me autorët, performuesit dhe shoqatat e tyre, me qëllim që të jemi sa më të suksesshëm për krijimin e një sistemi të të drejtave të autorit, ku krijuesit e performuesit mbrohen e kompensohen për punën e tyre", është shprehur ministri Gashi. Në fund të fjalës në këtë konferencë vuri theksin te zbatimi i ligjit, duke thënë se "vetëm duke zbatuar Ligjin për të drejtat e autorit mund të ketë një zhvillim të krijimtarisë artistike, shkencore dhe kulturës në përgjithësi, përfshirë këtu zhvillimin e industrive kreative dhe medie të shkruara dhe elektronike së bashku me radio dhe televizione".

Nënshkruhet memorandumi me Fondacionin Trashëgimia Kulturore pa Kufij

PRISHTINË, 26 PRILL (ER) - Është nënshkruar memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Komunitetit të Prishtinës dhe Fondacionit Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHWB) lidhur me zhvillimin e pjesës së projektimit, ekspertizës dhe mbështetjes që të bëhen mbrojtja, promovimi dhe konservimi i trashëgimisë kulturore në Komunën e Prishtinës.



Qëllimi i memorandumit të nënshkruar është projektimi i një rruge model për Qendrën Historike të Prishtinës, hartimi i planit të konservimit për

Qendrën Historike të Prishtinës ku do të përcaktohen kufijtë e Qendrës dhe të ofrohet mbështetje e përgjithshme në fushën e trashëgimisë kulturore përmes projekteve që lidhen me promovimin e trashëgimisë kulturore në Komunën e Prishtinës, si dhe në projektet që ndërlihen me turizëm, arkitekturë dhe historik në qytet.

Mbahet simpoziumi i parë politik për të drejtën e ribashkimit kombëtar shqiptar

PRISHTINË, 26 PRILL - Në Institutin Albanologjik në Prishtinë të enjten është mbajtur simpoziumi i parë politik dhe diplomatik lidhur me të drejtën e ribashkimit kombëtar shqiptar. Në këtë simpozium kanë marrë pjesë përfaqësues dhe iniciues nga Lëvizja Pellazge-ilire Shqiptare në krye me Sali Salihun, përfaqësues nga Partia Republikane e Kosovës, Shoqata Atdhetare për Identitet dhe Bashkim Kombëtar-Kolosët e Kombit, Sadik Rama Gjyrgjeviku, Unioni Demokratik Shqiptar Medvegjë (prof. Rexhep Abazi), Lëvizja Gjithëpopullore Kombëtare Shqiptare Pajtimi i Gjaqeve, Shoqata e Muhaxherëve Preshevë,



Republika e Çamërisë në krye me Festim Lato - Bruksel, akademik, diplomat Brano Sinodiovski (Shkup me 94 mijë anëtarë të Maqedonisë shqiptare juglindore).

Në këtë simpozium janë lexuar 12 kumtesa nga prof. dr. Ilaz Rexha, ekspert i osmanistikës, prof. dr. Sejfullah Peza - Tiranë, prof. dr. Hysen Matoshi, prof. dr. Sadri Fetiu, Sali Salihu, prof. dr. Bedri Muhadri, Behram Hoti, Hasie Selishta, Simon Veseli, Ferat Ymeri, Cenë Pushkollli, Halil Canolli, Luljeta Bajqinovci, Hoxhë Mustafë Havolli, Sahit Rama, Florim Isufi si dhe një numër i konsiderueshëm i debatuesve që kontribuan për këtë simpozium të lartpërmendur.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Alban Sllamniku shpall të pavlefshme diplomën e lëshuar nga shkolla e mesme ekonomike "Hivzi Sylejmani" Fushë Kosovë.

► D.P.T "Albioni" nga Vushtrria shpall të pavlefshëm certifikatën e biznesit me numër: 80316208.

► D.P.T "Albioni" nga Vushtrria shpall të pavlefshme numrin fiskal: 600245569.

► Urgjentisht kërkohet një garsoniere për blerje në Fushë Kosovë. Çmimi 20.000 euro. Informatat në tel: 049 472 770

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift në Fushe Kosove. Banesa duhet të ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë të jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira në Prishtinë, për një çift me një fëmijë. Banesa duhet të ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektesë si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

E rrallë

Deti "pushtohet" nga ndotja plastike

Disa grimca plastike janë zbuluar në akullin e Detit Arktik, duke ngritur shqetësime rreth ndikimit të tyre tek jeta detare dhe njerëzit, kanë njoftuar shkencëtarët. Rreth 12 000 pjesë plastike janë gjetur për një litër akull deti, gjë që u zbulua në mostrat e marra nga katër rajone të Oqeanit Arktik në vitin 2014 dhe 2015.




FOTO E DITES



Policët marrin pjesë në një stërvitje të masave të sigurisë në ishullin Boracay në Filipine. /AFP/

E jashtëzakonshme

Kafja më e shtrenjtë në botë del nga kjo krijesë

Kafja e quajtur "Kopi lumak" është e njohur si një nga kafet më të shtrenjta në botë me rreth 700 dollarë për kilogram. Si është e bërë? Një kafshë e vogël aziatike ushqehet me kafën e papjekur në pemë dhe më pas i nxjerr në formë jashtëqitje



dhe më pas ato mblidhen për t'u konsumuar nga njerëzit.

BARSOLETA E DITËS



Babai: Cila është arsyeja që ke kaq shumë mungesa në gjuhën shqipe?
Djali: Nuk e di, se nuk kam qenë aty.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:30

"BLACK PANTHER" 3D (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 2 orë 15 min

Rolet: Chadwick Boseman, Angela Basset, Michael B. Jordan, Lupita Nyong'o, Martin Freeman, Forest Whitaker, Andy Serkis, etj.
Regjia: Ryan Coogler



Në ora 17:00

"PETER RABBIT"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 33 min

Rolet: James Corden, Rose Byrne, Domhnall Gleeson, Sam Neill, Daisy Ridley, Elizabeth Debicki, Margot Robbie, etj.
Regjia: Will Gluck



Në ora 19:00

"PACIFIC RIM UPRISING" (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 1 orë 51 min

Rolet: John Boyega, Scott Eastwood, Jing Tian, Cailee Spaeny, Rinko Kikuchi, Burn Gorman, Adria Arjona, Charlie Day, etj.
Regjia: Steven S. DeKnight



Në ora 21:00

"RED SPARROW" (R)

Mister/Triller; 2 orë 25 min

Rolet: Jenifer Lawrence, Joel Edgerton, Matthias Shoenearts, Jeremy Irons, Mary-Louise Parker, Charlotte Rampling, etj.
Regjia: Francis Lawrence



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).



DASHI

Edhe pse puna juaj ka ngarkesë,

eporët tuaj nuk e kanë vënë re këtë gjë. Lejoni që kjo gjë të merret vesh sepse do të keni përfitime financiare.



DEMI

Jeni person që i vlerësoni të gjitha detajet

e një problemi dhe për këtë gjë miqtë tuaj gjithmonë besojnë tek ju.



BINJAKËT

Megjithëse në shumë raste jeni të ndrojtur

në situata që shikoni që mund të cenoheni, personalisht ju dini të reagoni.



GAFORRJA

Sot po tregoni që jeni person

altruist dhe ndani shumë nga vetja me të tjerët. Kjo gjë do të vlerësohet nga një njeri i afërt.



LUANI

Zbulimi i një sekreti do t'ju vë në qendër

të vëmendjes. Nuk e dinit që ishit pjesë e diçkaje kaq të madhe.



VIRGJËRËSHA

Gjithmonë jeni treguar shumë të

zotë sa iu përket detajeve, por shpesh ju shpëtojnë gjërat madhore që prishin edhe më shumë punë.



PESHORJA

Sot ju pëlqen rutina e ditës suaj.

Keni përcaktuar rrjedhën e ditës dhe kjo gjë ju bën të relaksoheni më tepër.



AKREPI

Joshja që ushtroni tek seksi i kundërt sot

nuk do të kalojë pa u vënë re.



SHIGJETARI

Sot po merreni me investime

për ambientin e shtëpisë. E ndjeni që ka gjëra që ju mungojnë dhe që duhet t'i blini sa më shpejt.



BRICJAPI

Aftësia juaj për të marrë vendime të

shpejta ju bën të jeni një pikë reference për shumë nga personat që ju rrethojnë.



UJORI

Mbase ka ardhur momenti të shikoni

për një ambient të ri pune. E ndjeni që aty ku jeni keni dhënë gjithçka mundeni.



PESHQIT

Jeni shumë kureshtar dhe nuk do

të ndaleni derisa t'i merrni përgjigjet që kërkonin për çështje të caktuara.

EURO GLASS
SAINT-JOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Envert

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

FULHAM - SUNDERLAND

1&3+

ABERDEEN - HEARTS

1GG

LEVANTE - SEVILLA

2

Jashari: E mposhtim Prishtinën dhe e ndjekim titullin

Mbrojtësi Dardan Jashari ka thënë të enjten për "Epokën e re" se Llapit nuk ka hequr ende dorë nga titulli i kampionit. "Do të luftojmë derisa të na lejojë matematika. Nuk do të dorëzohemi deri në fund të kampionatit sepse jemi një skuadër serioze dhe nuk dorëzohemi lehtë", ka thënë Dardan Jashari

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 26 PRILL - Skuadra e Llapit ka mbetur 12 pikë larg skuadrës lidere në Vala Superligën e Kosovës në futboll, Dritës. Megjithatë, Dardan Jashari ka thënë të hënën për "Epokën e re" se skuadra nga Besiana ende nuk ka hequr dorë nga titulli i kampionit. "Do të luftojmë derisa të na lejojë matematika. Nuk do të dorëzohemi deri në fund të kampionatit sepse jemi një skuadër serioze dhe nuk dorëzohemi lehtë", ka thënë Dardan Jashari, i cili është një nga lojtarët më të dalluar në skuadrën e Llapit.

Skuadra e drejtuar nga Tahir Batatina arriti të shpallet kampione vjeshtore, por në sezonin pranveror nuk ishte e njëjta çka bëri që të mbetet edhe një hap pas në garën për titull. Lidhur me këtë fenomen, Jashari ka shtuar se kjo u ndodh edhe skuadrave të mëdha evropiane. "Kjo që i

ndodhi Llapit në këtë edicion u ndodh edhe skuadrave të mëdha evropiane. Ne tash e kemi kaluar krizën dhe në ndeshjet e radhës synojmë ta marrim maksimumin e pikëve", ka deklaruar ai. Skuadra e Llapit, pas humbjes në fundjavën e kaluar nga Drita në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Besianë (1-3), të dielën e zhvillon ndeshjen e radhës ndaj skuadrës së Prishtinës. Futbollisti Dardan



Ja kur zhvillohet finalja e Kupës dhe ndeshjet e barazhit

Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ka njoftuar se finalja e Digitalb Kupës së Kosovës në futboll do të zhvillohet më 27 mars në orën 16:00. Në finale takohen Prishtina dhe Vëllaznimi, kurse ndeshja zhvillohet në stadiumin olimpiq "Adem Jashari" në Mitrovicë. Ndërsa ndeshjet e barazhit për Vala Superligë do të luhen më 23 dhe 31 maj në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas, në orën 16:00, kurse ndeshjet e barazhit për Ligën e Parë, më 28 e 29 maj, në Gjakovë, në orën 16:00.

Jashari paralajmëron se në këtë ndeshje skuadra e Llapit do të luajë për fitore. "Për ndeshjen ndaj Prishtinës nuk jemi të kompletuar, por kemi synime të mëdha. Përballë e kemi një skuadër të fortë që ka futbollistë cilësorë, por ne si në çdo ndeshje hyjmë për fitore", ka përfunduar Jashari. Skuadra e Llapit aktualisht renditet në pozitën e tretë me 45 pikë të grumbulluara, ku nga 28 ndeshjet të zhvilluara, regjistroi 13 fitore, 6 barazime dhe 9 humbje.

Nora, e artë në Izrael; Distria, e argjendte

PRISHTINË, 26 PRILL - Kosova e arrin edhe një sukses të madh në sportin e xhudos, pasi Nora Gjakova dhe Distria Krasniqi kanë fituar medalje në Kampionatin Evropian që po mbahet në Izrael. Nora është shpallur kampione e Evropës, pasi në finale e ka mposhtur gjermanen Theresa Stoll me ippon në kategorinë -57 kg. Është kjo medalja e parë e artë për Nora Gjakovën në një kampionat të tillë për seniorë, kurse vitin e kaluar Gjakova ka fituar medaljen e bronzit. Duhet cekur se Nora në rrethin e parë mundi Ichinkholoo (Azerbajxhan), në të dytën Acelya Toprak (Britani e

Madhe), kurse në çerekfinale Telma Moreiron (Portugali). Finalen e siguroi pas triumfit ndaj ruses Anastasiia Konkina. Distria Krasniqi është nënkampione e Evropës në kategorinë -52 kg. Ajo fitoi medaljen e argjendte në Kampionatin Evropian "Tel Aviv 2018". Ajo ishte e pafat në finale, duke u mposhtur nga rusja Natalia Kuziutina, me ippon, pas shënimit të artë. Kuziutina është medaliste e bronzit nga Lojërat Olimpike "Rio 2016", derisa për herë të katërt fitoi të artën në kampionate evropiane. Vitin e kaluar u mposht në finale nga Majlinda Kelmendi. Rrethin e parë, Distria e kaloi pa luftë, në



